

“Rec Kos” SH.P.K.

Adresa: Rr. Pajazit Islami, Nr. 186, Fushë Kosovë



RAPORTI I VLERËSIMIT TË NDIKIMIT NË MJEDIS

Për Qendrën e Grumbullimit, Çmontimit dhe Përpunimit të Automjeteve Mbeturinë, përpunimit të mbeturinave metalike për Qëllime Riciklimi, Grumbullimin e Vajrave të Përdorura, Mbeturinave nga Pajisjet Elektrike dhe Elektronike, Mbeturinave nga Konstruktimi dhe Demolimi, Mbeturinat Komunale si dhe Mbeturinat e Paspecifikuara Ndryshe

Investitor: “Rec Kos” sh.p.k.,

Lokacioni: Fshati Sankoc, Komuna Glllogoc

Email: info@reckos.net

Nr. Tel.: +383 49 999 821

RAPORTI I VLERËSIMIT TË NDIKIMIT NË MJEDIS

Për Qendrën e Grumbullimit, Çmontimit dhe Përpunimit të Automjeteve Mbeturinë, përpunimit të mbeturinave metalike për Qëllime Riciklimi, Grumbullimin e Vajrave të Përdorura, Mbeturinave nga Pajisjet Elektrike dhe Elektronike, Mbeturinave nga Konstruktimi dhe Demolimi, Mbeturinat Komunale si dhe Mbeturinat e Paspesifikuara Ndryshe me Investitor “Rec Kos” sh.p.k., me Lokacion në Fshatin Sankoc, Komuna e Glllogoc-it
Ngastrat me nr.: 00230-2, 00230-3, 00230-4, 00230-5, 00231-2, 00231-3, 00231-4, 00231-5,
Zona Kadastrale Sankoc, Komuna Glllogoc

Te dhenat:	Emri I Investitorit
Aplikuesi	Sevdai Ahmeti, Person i Autorizuar
Investitori	“Rec Kos” SH.P.K.
Adresa:	Rr. Pajazit Islami, Nr. 186, Fushë Kosovë
Lokacioni:	Zona Industriale, Fshati Sankoc, Komuna Glllogoc
Tel:	+383 49 999 821
Email:	sevdai.ahmeti@reckos.net, info@reckos.net

Investitori:

“Rec Kos” SH.P.K.

Emri i Hartuesit të Raportit të VNM-së

Bsc. Hidro. Blerina Bajraktari

Nënshkrimi

Nënshkrimi

Blerinabajraktari1@gmail.com

+383 49 588 634

Tetor, 2025

PËRMBAJTJA:

1.	HYRJE.....	1
2.	KORNIZA LIGJOR PËR HARTIMIN E RAPORTIT TË VNM-së	2
3.	PËR KOMPANINË	3
a)	Vendndodhja e Qendrës se Grumbullimit.....	8
b)	Përshkrimi i veçorive kryesore Fizike të Projektit	11
c)	Përshkrimi i veçorive kryesore të fazës operative të projektit	15
d)	Makinerite e Punes dhe Perpunimit:.....	18
e)	Përshkrimi i detajuar i procesit teknologjik në kompaninë “Rec Kos” Sh.p.k.	25
f)	Përshkrimi i detajuar i procesit teknologjik për kodet shtesë të kërkuara nga kompania “Rec Kos” Sh.p.k.....	27
g)	Përlllogaritja sipas llojit dhe sasisë të mbetjeve dhe emetimeve të pritura gjate fazës së operimit.....	31
└	Parimet e llogaritjes.....	31
└	Ajri.....	31
└	Masa të zbatuara	31
└	Uji.....	32
	Masa të zbatuara	32
└	Dheu dhe toka.....	32
└	Masa të zbatuara	32
└	Zhurma.....	32
└	Dridhjet.....	33
└	Drita, nxehësia, rrezatimi	33
└	Flora dhe fauna.....	33
└	Ndikimet sociale dhe ekonomike.....	33
└	Masat që e mbajnë ndikimin të ulët.....	33
4.	PËRSHKRIMI I ALTERNATIVAVE TË ARSYESHME.....	34
5.	GJENDJAAKTUALE E MJEDISIT.....	36

5.1	Flora dhe Fauna.....	36
5.2	Hidrografia.....	37
6.	IDENTIFIKIMI DHE PËRSHKRIMI I NDIKIMEVE NË MJEDIS.....	39
6.1	Ndikimet në ajër.....	39
6.2	Ndikimet në tokë.....	40
6.3	Ndikimet në ujë.....	40
6.4	Ndikimet në peizazh, florë dhe faunë	41
6.5	Ndikimet në vendbanime dhe populate.....	41
6.6	Ndikimet nga zhurma.....	41
6.7	Ndikimet në raste të aksidenteve mjedisore	42
6.8	Ndikimi mjedisor nga mbeturinat.....	42
6.9	Trashëgimia Kulturore	43
7.	PËRSHKRIMI I PASOJAVE TË MUNDËSHME NË MJEDIS	43
8.	PËRSHKRIMI I METODAVE PËR VLERËSIMIN E PASOJAVE MJEDISORE.....	46
9.	PËRSHKRIMI I MASAVE	48
9.1	Masat për zvogëlimin e ndikimeve në ajër.....	48
9.2	Masat për zvogëlimin e ndikimeve në tokë	48
9.3	Masat për zvogëlimin e ndikimeve në ujë.....	49
9.4	Masat për mbrojtje nga zhurma.....	49
9.5	Masat për zvogëlimin e ndikimeve në peizazh, florë dhe faunë	50
9.6	Masat për zvogëlimin e ndikimeve në vendbanime dhe popullatë.....	50
9.7	Masat për menaxhimin e mbeturinave	50
9.8	Masat rehabilituese	51
9.9	Komponentë mjedisore, potenciali për ndikim, veprimet që shkaktojnë ndikimet dhe masat për parandalimin e këtyre ndikimeve.....	52
10.	PËRSHKRIMI I PASOJAVE NEGATIVE MJEDISORE.....	54
11.	MONITORIMI DHE RAPORTIMI.....	55
12.	PËRFUNDIM	56

13.	LITERATURA E PERDORUR.....	58
-----	----------------------------	----

Lista e Figurave

Figura 1	Shtirirja e Lokacionit te kompanise në territorin e Kosoves dhe Glllogocit	9
Figura 2.	Parcelat ku jane të vendosura Objektet e Kompanisë “Rec Kos” Sh..p.k. ZK. Sankoc K. Glllogoc.....	10
Figura 3.	Distanca e kompanisë me qytetin e Glllogocit	10
Figura 4.	Distanca e objektit me industrite tjera ne afersi.....	11
Figura 5	Hyrja ne Qendër dhe Objekti i Administratës "Rec Kos" Sh.p.k.....	12
Figura 6	Situacioni i objekteve dhe largimi i ujerave fekale e atmosferike nga kompania "Rec Kos" Shpk.....	12
Figura 7	Objekti i Administratës	13
Figura 8	Objekti i Puntorisë 1 dhe 2.....	14
Figura 9	Objekti Puntoria 3 me pamje të objektit	15
Figura 10	Objekti Puntoria 4, me pamje të Objektit.....	15
Figura 11.	Procesi i pune se presës për prerjen e metaleve	18
Figura 12	Krijim i dangjeve.....	18
Figura 13	Krijimi i dangjeve pas çmontimit te makinave	19
Figura 14	Makine për bluarjen e mbeturinave metalike	19
Figura 15.	Materialet pas procesit te punës	20
Figura 16	Grumbullimi i materialeve	21
Figura 17	palëtimi i llojeve te ndryshme te materialeve	22
Figura 18.	Paketimi i materialeve.....	23
Figura 19.	Transporti i materialeve me kamion	24
Figura 20.	Rrjeti Hidrografik i Komunës së Glllogoci	38

Lista e Tabelave:

Tabela 1	Kodet të cilat i posedon kompania	4
Tabela 2	Kodet e mbeturinave shtese dhe atyre ekzistuese	5
Tabela 3	Paraqitja e mbeturinave sipas katalogut shtetëror vetëm ato te krijuara nga punëtorët.....	43
Tabela 4	Tabela e kodeve ekzistuese te mbeturinave dhe atyre shtese te kërkuara nga Kompania.....	57

1. HYRJJE

Kompania Investuese “Rec Kos” SH.P.K. me seli në Komunen e Fushë Kosovës, ka ngritur Qendrën për Grumbullimin, Çmontimin dhe Përpunimin e Automjeteve Mbeturinë, përpunimin e mbeturinave metalike për Qëllime Riciklimi, Grumbullimin e Vajrave të Përdorura, Mbeturinave nga Pajisjet Elektrike dhe Elektronike, Mbeturinave nga Konstruktimi dhe Demolimi, Mbeturinat Komunale si dhe Mbeturinat e Paspecifikuara, ne lokacionin e ri ne fshatin Sankoc të Komunes së Gllogoc-it e cila eshte më e madhja ne Kosovë. Hartimi i Raportit të Vlerësimit të Ndikimit në Mjedis është një kërkesë e cila del nga Ligji nr. 08/L-181 për Vlerësimin e Ndikimit në Mjedis për t'u siguruar që kompania “Rec Kos” Sh.p.k., vepron në përputhje me standardet mjedisore të vendosura nga ligjet vendore dhe ndërkombëtare për menaxhimin e mbeturinave. Kjo përfshin respektimin e normave për ndotjen e ajrit, kontrollin e emisioneve dhe mbrojtjen e burimeve ujore dhe tokësore. Ky Raport behet për arsye se kompania ka bere zgjerimin dhe rritjen e kapaciteteve të perpunimit të mbeturinave dhe përfshin trajtimin e llojeve të reja të mbetjeve, të cilat mund të kenë ndikime specifike në mjedis. Qendrat për Grumbullimin e mbeturinave, krijojnë potencialisht ndotës të ndryshëm që duhet të vlerësohen për ndikimin e tyre mbi ajrin, ujin dhe tokën.

Përmes këtij Raporti të VNM -së do të përkufizohen të gjitha ndikimet që mundë të paraqiten në relacionin e Qendrës për Grumbullimin e mbeturinave nga kompania “Rec Kos” SH.P.K., duke pasur parasysh mjedisin jetësor të ngushtë dhe të gjerë.

Ky vlerësim i ndikimit në mjedis është punuar duke u bazuar në rritjen e kërkesave nga operatorët, gjendjen aktuale te lokacionit, karakteristikat e lokacionit, gjendjen ekzistuese të mjedisit rreth lokacionit të kompanisë dhe dokumentit teknik ekzistues. Detyra e përgatitjes së këtij raporti të VNM-së, kryesisht ka për qëllim identifikimin e burimeve të ndotjes, vlerësimin e ndikimit të tyre në mjedis si dhe propozimin e veprimeve për parandalimin apo së paku zvogëlimin e ndikimeve negative ne mjedis deri në kufijtë e lejuar. Të gjitha konstatimet dhe rekomandimet për mbrojtjen e mjedisit që dalin nga ky raport, duhet të merren për bazë, gjatë fazës së operimit sepse kompania tashme ka ndërtuar objektin.

Në përgjithësi, raporti i VNM-së për “Rec Kos” Sh.p.k., siguron që operacionet e saj, ne rritjen e kapaciteteve, janë të sigurta, të qëndrueshme dhe në përputhje me standardet mjedisore dhe të shëndetit publik.

2. KORNIZA LIGJOR PËR HARTIMIN E RAPORTIT TË VNM-së

Bazuar në karakteristikat e Qendrës për Grumbullimin, Çmontimin dhe Përpunimin e Automjeteve Mbeturinë, përpunimin e mbeturinave metalike për Qëllime Riciklimi, Grumbullimin e Vajrave të Përdorura, Mbeturinave nga Pajisjet Elektrike dhe Elektronike, Mbeturinave nga Konstruktimi dhe Demolimi, Mbeturinat Komunale si dhe Mbeturinat e Paspecifikuara me të gjithë infrastrukturën përcjellëse dhe sipas projektit të përfunduar, ku ky projekt është subjekt i vlerësimit të ndikimit në mjedis. Ligji Nr. 08/L-181 për Vlerësimin e Ndikimit në Mjedis i cili është baza kryesore ligjore të cilit ju kemi referuar. Shtojca 1 e këtij ligji, paragrafi 8:

Për përgatitjen e këtij raporti janë konsultuar edhe ligje të tjera relevante, si:

Ligjet:

- Ligji për Mbrojtjen e Mjedisit Nr. 03/L-025;
- Ligji për Vlerësimin e Ndikimit në Mjedis Nr.08/L-181;
- Ligji për Mbeturina Nr. 04/L-060;
- Ligji nr. 08/l-071 për ndryshimin dhe plotësimin e ligjit nr.04/l-060 për mbeturina
- Ligji për Planifikim Hapësinor Nr. 04/L-174;
- Ligji për Tokën Bujqësore Nr. 02/L- 26;
- Ligji për Mbrojtjen nga Zhurma Nr. 02/L-102;
- Ligji për Ujërat e Kosovës Nr. 04/L-147;
- Ligji për Mbrojtjen e Ajrit nga Ndotja Nr. 08/L-025;
- Ligji për Mbrojtjen e Natyrës Nr.03/L-233
- Ligji për mbrojtjen nga Zjarri Nr.08/L-261

Udhëzimet Administrative:

- Udhëzim Administrativ Nr.13/2013 për Katalogun Shtetëror të Mbeturinave;
- Udhëzimi Administrativ (QRK)-Nr.03/2021 për menaxhimin e mbeturinave të rrezikshme;
- Udhëzim Administrativ MMPH-Nr.26/2014 për menaxhimin e mbeturinave nga betërit dhe akumtatorët
- Udhëzim Administrativ Nr. 16/2013 për vlerat kufitare të përqendrimeve për komponentët e rrezikshme në mbeturina
- Udhëzim Administrativ Nr. 05/2013 për menaxhimin e vajrave të përdorura dhe mbeturinave me vajra

- Udhëzimi Administrativ nr. 06/2008 për administrimin e mbeturinave të rrezikshme
- Udhëzimit Administrativ (QRK) Nr. 07/2021 për rregullat dhe normat e shkarkimeve në ajër nga burimet e palëvizshme të ndotjes;
- Udhëzimi Administrativ Nr.02/2022 për kushtet, mënyrat, parametrat dhe vlerat kufizuese të shkarkimit të ujërave të ndotura në rrjetin e kanalizimit publik dhe në trupin ujqor;

Pasi që për këtë veprimtari përdoren disa materiale që hynë tek kategoritë më të rrezikshme atëherë është e nevojshme të bëhet vlerësimi i ndikimit në mjedis (VNM) për rritjen e kapacitetit dhe grumbullimin e mbeturinave tjera për të adresuar ndikimet mjedisore të mundshme, masat për zvogëlimin e ndikimeve dhe përputhshmërinë ligjore. Investitori ka vendosur që të kryej një studim përkatës të vlerësimit të ndikimit në mjedis, të përgatis raportin dhe të aplikojë për pëlqim mjedisor në Ministrinë e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturë (MMPHI).

3. PËR KOMPANINË

“Rec-Kos” është njëra ndër kompanitë më të mëdha në Evropën Juglindore në industrinë e riciklimit të metaleve. Kompania merret me mbledhjen, përpunimin, seleksionimin dhe tregtimin e metaleve me ngjyra, elektronikës, plastikës së mbeturinave dhe vajrave të përdorur. “Rec-Kos” është kryesisht eksportuese e skrapit të riciklueshëm metalik, të cilin e siguron në Kosovë, e përpunon për përdorim të dytë dhe e shet si lëndë të parë për ne fabrika e çelikut. Materialet e mbledhura blihen kryesisht nga kompanitë që nxjerrin pjesë të vjetra nga amortizimet dhe i shesin përmes kontratave dhe tenderëve të ndryshëm, tregtarët e skrapit, autoritetet lokale si dhe furnizuesit publikë. Një sasi e vogël blihet gjithashtu edhe nga shitësit individualë në rrugë.

“Rec-Kos” ofron të gjitha llojet e metaleve të përdorura dhe të ricikluara, duke ricikluar metale të zeza dhe me ngjyra, që përfshijnë hekurin, çelikun, aluminin, bakrin, plumbin, inoksin, zinkun dhe materiale të tjera ricikluese.

Historia e kompanisë fillon në vitin 2000 si kompani riciklimi, ndërsa në vitin 2008 u themelua zyrtarisht si “REC-KOS” Sh.p.k.

Sot, kompania operon në Kosovë si një nga fushat më të mëdha të përpunimit të skrapit, metaleve me ngjyra, plastikës etj.

Rec-Kos, me mbi 150 punonjës, e zhvillon veprimtarinë e saj përmes pajisjeve moderne si ekskavatorë, presa, makineri për përpunim, kamionë dhe pajisje të tjera ndihmëse. Kompania kryesisht eksporton materialet në Bashkimin Evropian dhe në të gjitha vendet e rajonit, dhe është e pajisur me të gjitha lejet e nevojshme për përpunimin e metaleve si dhe për eksportin e tyre.

Rec-Kos është e përkushtuar ndaj qëndrueshmërisë mjedisore. Kompania njeh rëndësinë e mbrojtjes së burimeve natyrore të planetit dhe fokusi i saj kryesor mbetet qasja strategjike në menaxhimin e zgjuar dhe ripërdorimin e burimeve.

Çdo material i kontaminuar që identifikohet trajtohet në përputhje me rregulloret dhe hiqet nga cikli i riciklimit, duke siguruar mbrojtje të plotë për mjedisin. Të gjitha proceset kompania i zhvillon në përputhje me standardet më të larta mjedisore, dhe kompania gjithmonë ka synuar të arrijë nivelet më të larta të kontrollit të cilësisë.

Për më tepër, të gjitha materialet që hyjnë ose dalin nga objektet e saj, kalojnë përmes pajisjeve të detektimit të rrezatimit në portë, për të siguruar mbrojtjen e punonjësve, pajisjeve, mjedisit dhe klientëve tanë. Kodet të cilat i posedon kompania dhe kodet të cilat planifiko ti shtojë janë të paraqitura në tabelën në vijim :

Tabela 1 Kodet të cilat i posedon kompania

Kodet të Cilat i Posedon kompania	Emërtimi i mbeturinës
13 01 01*	Vajrat hidraulike, që përmbajnë PCB
13 03 01*	Mbeturina vajrash izoluese dhe vajrat përcjellëse që përmbajnë
15 01 02	Ambalazhe plastike
15 01 04	Ambalazhe metalike
	Mbeturina Ambalazhi të përbëra
15 01 06	Ambalazhe të përziera
16 01 03	Goma të Vjetra
16 01 04*	Automjete të vjetra
16 01 06	Automjete jashtë përdorimit që nuk përmbajnë lëngje apo komponentë tjera të rrezikshme
16 02 09*	Transformatorët dhe kondensatorët që përmbajnë PCB
16 02 10*	Paisjet për hudhje që përmbajnë apo janë të kontaminuara nga PCB ose PCT, tjera nga ato të përmendura në 160209

16 02 11*	Paisjet për hudhje që përmbajnë kloroflorokarbone
16 02 12*	Pajisje për hudhje që përmbajnë asbest të lirë
16 02 13*	Pajisje për hudhje që përmbajnë komponente të rrezikshëm, tjera nga ato të përmendura në 160209 dhe 160212
16 02 14	Pajisje për hudhje, tjera nga ato 160209 dhe 160213
16 02 15*	Komponentët e rrezikshme të larguara nga mjetet për hudhje
16 02 16*	Komponentët tjerë të larguar nga mjetet për hudhje, tjera nga ato të përmendura në 160215
16 06 01*	Bateritë e plumbit
16 06 02*	Bateritë Ni-Cd
16 06 05	Bateritë dhe akumulatorët tjerë
16 08 01	Katalizatorët e hargjuar që kanë ar, argjend, renium, radium, paladium, iridium, ose platinium (përveç 16 08 07)
17 02 03	Plastika
17 04 01	Bakri, bronzi, tunxhi
17 04 02	Alumini
17 04 03	Plumbi
17 04 04	Zinku
17 04 05	Hekuri dhe Çeliku
17 04 06	Kallaji
17 04 07	Metalet e përziera
20 01 23*	Pajisjet për hudhje që përmbajnë klorofluorokarbonë
20 01 35*	Pajisje elektrike dhe elektronike për hudhje tjera nga ato të përmendura në 200121 dhe 200123 që përmbajnë komponente të rrezikshme

Kodet të cilat të shtohen janë paraqitur në tabelën si më poshtë:

Tabela 2 Kodet e mbeturinave shtese dhe atyre ekzistuese

Tabelave e kodeve me Leje dhe Atyre shtesë të kërkuara	
02 01 10	Mbeturinat metalike
04 01 09	Mbeturinat nga veshjet dhe procesi përfundimtar
04 02 09	Mbeturinat nga materialet e përziera (tekstil i impenjuar elastomeri, plastomeri)
07 02 13	Mbeturinat plastike
08 01 11*	Mbeturinat e ngjyrave dhe llaqeve që përmbajnë tretësira organike ose substanca tjera të rrezikshme,
08 01 12	Mbeturinat tjera të ngjyrave dhe llaqeve ndryshe nga ato të përmendura në 08 01 11

10 01 01	Hiri nga fundi, llum dhe pluhur kaldajash (përfshijtur pluhurin e kaldajave të përmendura në 10 01 04)
10 01 02	Hiri fluturues nga thëngjilli
10 03 02	Skrapiet e anodave
10 03 05	Mbeturinat nga alumini
10 03 20	Pluhur nga tymi i oxhakut, tjera nga ato të përmendura në 10 03 19
10 04 01*	Llumrat nga prodhimi primar dhe sekondar
10 06 01	Llumrat nga prodhimi primar dhe sekondar
10 09 03	Llumra nga furra për shkrirje
10 10 03	Llumra nga furra për shkrirje
10 12 01	Mbeturinat nga përgatitja e përzierjes para procesit termik
10 12 06	Kallëpet e përdorur
10 12 08	Mbeturinat qeramike, tullave, pllakave dhe produkteve të ndërtimit (pas përpunimit termik)
10 13 01	Mbeturinat nga përgatitja e përzierjes para procesit termik
10 13 14	Mbeturinat të betonit dhe llumra të Betonit
11 05 01	Zinku i rend
11 05 02	Hiri i zinkut
12 01 13	Mbeturinat nga saldimi
13 01 09*	Vajrat hidraulike të kloruara me baze minerale
13 01 10*	Vajrat hidraulike të pakloruara me baze minerale
13 01 11*	Vajrat hidraulike sintetike
13 01 12*	Vajrat hidraulike lehtësisht të biodegradueshme
13 01 13*	Vajrat tjera hidraulikë
13 02 04*	Vajra motori ingranazhesh dhe lubrifikues të kloruara me baze minerale
13 02 05*	Vajra motori ingranazhesh/ dhëmbëzoret dhe lubrifikues të pa kloruara me baze minerale
13 02 06*	Vaje sintetike motori, ingranazhi/dhëmbëzore dhe lubrifikues
13 02 07*	Vajra lehtësisht të biodegradueshme : motori, ingranazhi dhe lubrifikanti
13 02 08*	Vajra tjera motori, ingranazhi dhe lubrifikant
13 05 06*	Vaji nga separatorët Ujë/Vaj

13 05 07*	Ujë me vaj nga seperatoret uje/vaj
15 01 01	Ambalazhe letre dhe kartoni
15 01 03	Ambalazhe druri
15 01 07	Ambalazhe qelqi
15 01 09	Ambalazh tekstili
15 01 11*	Mbeturina ambalazhi metalike që përmbajnë materiale të ngurta poroze (psh azbest), duke përfshirë kontejnerët bosh të presioneve
15 02 02*	Absorbuesit-filtrat nga materiali (përfshirë filtrat te paspecifikuara ndryshe), leckat për fshirje, veshjet mbrojtëse te kontaminuara me substanca te rrezikshme
16 01 07*	Filtra vaji
16 01 09*	Komponentët qe përmbajnë PCB
16 01 13*	Lëngje frenash
16 01 17	Metale ferore
16 01 18	Metale jo ferore
16 01 19	Plastika
16 01 20	Qelqi
17 01 01	Betoni
17 01 02	Tulla
17 01 03	Tjegulla dhe kerkamika
17 01 07	Përzierje te betonit, tullave, tjegullave dhe qeramikës tjera nga ato te përmendura ne 17 01 06
17 02 02	Qelqi
17 06 01*	Materialet izoluese qe përmbajnë azbest
17 06 03*	Materiale tjera izolimi qe konsistojnë ose përmbajnë substanca te rrezikshme,
17 06 04	Materiale izolimi, tjera nga ato te përmendura ne 17 06 01 dhe 17 06 03
17 06 05*	Materiale ndërtimi qe përmbajnë asbest
17 08 02	Mbeturina ndërtimi me gips, tjera nga ato te përmendura ne 17 08 01
17 09 04	Mbeturina te përziera nga ndërtimi dhe demolimi, tjera nga ato te përmendura ne 17 09 01, 17 09 02 dhe 17 09 03

19 10 01	Mbeturinat te hekurit dhe çelikut
19 12 01	Letër dhe karton
19 12 02	Metale ferore
19 12 03	Metale joferore
19 12 04	Plastikë dhe gomë
19 12 05	Qelqi
20 01 01	Letër dhe karton
20 01 02	Qelqi
20 01 11	Tekstili
20 01 33*	Bateritë dhe akumulatorët e përfshirë në 16 06 01, 16 06 02 ose 16 06 03 dhe bateritë dhe akumulatorët e pandarë
20 01 34	Bateritë dhe akumulatorët, tjera nga ato të paraqitura në 20 01 33
20 01 36	Pajisje elektrike dhe elektronike për hudhje, tjera nga at te përmendura ne 20 01 21, 20 01 23 dhe 20 01 35
20 01 39	Plastika
20 01 40	Metalet
20 01 41	Mbeturinat nga pastrimi i oxhaqeve
20 03 01	Mbeturina e përziera komunale
20 03 02	Mbeturina nga tregjet
20 03 04	Llumra nga tanku septik
20 03 99	Mbeturinat komunale te pa specifikuara ndryshe

Ne tabelën e mësipërme janë paraqitur Kodet e mbeturinave sipas U.A. Nr. 13 /2013 për Katalogun Shtetëror të Mbeturinave, ku për disa prej tyre kompania ka Pëlqim dhe Leje Mjedisore.

a) Vendndodhja e Qendrës se Grumbullimit

Objekti i Qendrës për Grumbullimin, Çmontimin dhe Përpunimin e Automjeteve Mbeturinë, përpunimin e mbeturinave metalike për Qëllime Riciklimi, Grumbullimin e Vajrave të Përdorura, Mbeturinave nga Pajisjet Elektrike dhe Elektronike, Mbeturinave nga Konstruktimi dhe Demolimi, Mbeturinat Komunale si dhe Mbeturinat e Paspecifikuara ndryshe për rikuperimin e materialeve të klasifikuara, grumbullimin, trajtimin dhe përpunimin, ndodhet në

ngastrën kadastrale me nr. 00230-2, 00230-3, 00230-4, 00230-5, 00231-2, 00231-3, 00231-4, 00231-5, Zona kadastrale Sankoc, Komuna Gllogoc.

Fshati Sankoc kufizohet me fshatrat e komunës së Gllogocit siç janë: Korreticë e Epërme, Zabel i Ulët, Zabel i Epërm, Komoran, Fushticë e Poshtme, Fushticë e Epërme, me fshatrat e komunës se Fushë Kosovës si: Sllatina e Madhe, Harilaq dhe komunën e Lipjan: fshati Mirenë. Territori i komunës së Gllogocit shtrihet në pjesën e Kosovës qendrore. Sipërfaqja e gjithmbarshme e kësaj komune përfshinë 290 km² apo 2.66 % të sipërfaqes së territorit të Kosovës. Gjithë kjo trevë ,e cila përbëhet nga 42 vendbanime është e rrethuar me Malet e Berishës, Kasmaqit, Qyqavicës, Goleshit dhe Lipovicës(Blinajës). Kompania gjithesej ka ne shfrytëzim ka 9, 78 hektar.




Figura 1 Shtrirja e Lokacionit te kompanisë në territorin e Kosovës dhe Gllogocit

Në afërsi të "Rec Kos" SH.P.K., Qendrës për Grumbullimin, Çmontimin dhe Përpunimin e Automjeteve Mbeturinë, përpunimin e mbeturinave metalike për Qëllime Riciklimi,

Grumbullimin e Vajrave të Përdorura, Mbeturinave nga Pajisjet Elektrike dhe Elektronike, Mbeturinave nga Konstruktimi dhe Demolimi, Mbeturinat Komunale si dhe Mbeturinat e Paspecifikuara Sankoc, Gllogoc, të gjitha objektet janë me aktivitet industrial, dhe nuk ka shtëpi të banimit në afërsi.




Figura 4. Distanca e objektit me industritë tjera në afërsi

Sa i përket shtëpive të banimit, në afërsi të lokacionit nuk gjendet vendbanim pasi që zona është industriale dhe shtëpitë me të afërta gjenden mbi 1.4 km largët, ndërsa biznesi më i afërt është afër tij, ku objekti nga objekti është në një distancë prej 450 m largët.

b) Përshkrimi i veçorive kryesore Fizike të Projektit

Përshkrimi i saktë i Qendrës së Grumbullimit, Çmontimit dhe Përpunimit të Automjeteve të Mbetura, si dhe për përpunimin e mbeturinave metalike për qëllime riciklimi, grumbullimin e vajrave të përdorura, mbeturinave nga pajisjet elektrike dhe elektronike, mbeturinave nga konstruktimi dhe demolimi, mbeturinave komunale dhe atyre të paspecifikuara ndryshe, në zonën kadastrale Senkoc komuna e Drenasit, do të ketë disa objekte të cilët janë të ndarë sipas nevojës së shfrytëzimit, objektet do të jetë i ndarë si në vijim: Objekti i Administratës, hyrja e punëtorëve; Zyrat e stafit dhe menaxherit; Hapësira e kuzhinës dhe banjove; hapësira për kamionëve dhe peshim të mbeturinave, autoservisi për qmontimin e automjeteve mbeturinë,

Hapësira për vendosjen e mbeturinave depo/punishte; Hapësira për vendosjen e makineris, për coptim dhe presim, hapësirat/vaskat për vëndosjen e rezervuarve të vajit, impianti për trajtimin e ujit, të qendrës grumbulluese dhe çmontuese e automjeteve mbeturinë, mbeturinave metalike, grumbullim të vajrave të përdorura, si dhe mbeturinat nga paisjet elektrike.

Për kompaninë, “**Rec Kos**” SH.P.K. më poshtë do ti paraqesim veçoritë fizike të projektit:



Figura 5 Hyrja ne Qendër dhe Objekti i Administratës "Rec Kos" Sh.p.k.




Figura 6 Situacioni i objekteve dhe largimi i ujerave fekale e atmosferike nga kompania "Rec Kos" Shpk

- Objekti për Administratë,




Figura 7 Objekti i Administratës

- Objekti 1A - Streha e Hapur
- Objekti 2A – Streha e Mbyllur
- Objekti 1B – Streha e Hapur
- Objekti 2B – Streha e Mbyllur
- Objekti 1C – Streha e Hapur
- Objekti 1D – Streha e Hapur

Objekti i lartcekur parashihet të nga konstruksioni i çelikut i kombinuar me konstruksion të betonit të armuar me dimensione dhe aftësi mbajtëse të parapara për mbajtjen e ngarkesave punuese. Po ashtu objekti do të ketë të instaluar dhe sistemin e ajrimit dhe ventilimit, për pastrimin e ajrit brenda objektit. Hapësirat e mureve do të jenë të mbyllura me blloka të argjilës dhe pastaj të suvatuar dhe me termoizolime përkatëse, kulmi parashihet të jetë i mbuluar me sandëich panel me trashësi 10 cm.

Me poshtë do ti paraqesim disa foto te organizimit të impiantit dhe objektit të Punëtorisë 1-2 me sipërfaqe prej 456.623 m².



hapësirën $l=15.00\text{ m'}$ dhe kanë lartësinë $H1 = 9.70\text{ m}$;

Rastër i mbajtësve kryesore (ramave) është 5.00 m , muret e jashtme, brendshme si dhe mbulesa e kulmit janë nga panelet sandëich $d=12\text{ cm}$, të cilat vendosen, përforcohen në konstruksionet sekondare siç janë ato horizontale, vertikale dhe brinaket e kulmit. Fondimi i objektit bëhet me themele të veçuara të lidhura ndërmjet veti me traje shtangues.

Objekti – Punëtori – 3- Sipërfaqja $1,189.000\text{ m}^2$




Figura 9 Objekti Punëtori 3 me pamje të objektit




Figura 10 Objekti Punëtori 4, me pamje të Objektit

c) Përshkrimi i veçorive kryesore të fazës operative të projektit

Faza operative e projektit për Qendrën e Grumbullimit, Çmontimit dhe Përpunimit të Automjeteve të Mbetura, si dhe për përpunimin e mbeturinave metalike për qëllime riciklimi, grumbullimin e vajrave të përdorura, mbeturinave nga pajisjet elektrike dhe elektronike, mbeturinave nga konstruktimi dhe demolimi, mbeturinave komunale dhe atyre të paspecifikuara ndryshe, përfshin aktivitetet e përditshme të menaxhimit të integruar të mbeturinave. Këto procese zhvillohen në mënyrë të kontrolluar, të organizuar dhe të qëndrueshme, në përputhje me legjislacionin mjedisor të Republikës së Kosovës dhe standardet evropiane për menaxhimin e mbetjeve.

Pranimi dhe regjistrimi i mbeturinave

Çdo mbetje që hyn në qendër regjistrohet menjëherë në sistemin e kontrollit të kompanisë “Rec-Kos” Sh.p.k. Procesi përfshin peshimin, identifikimin sipas origjinës dhe klasifikimin në përputhje me Katalogun Shtetëror të Mbeturinave (UA Nr. 02/2013). Pas regjistrimit, kryhet kontrolli vizual për të verifikuar përbërjen dhe për të siguruar që mbetjet janë të përshtatshme për trajtim në objekt.

Çmontimi dhe ndarja e materialeve

Në rastin e automjeteve të mbetura dhe pajisjeve elektrike/elektronike, fillimisht realizohet procesi i çmontimit të kontrolluar, ku ndahen përbërësit kryesorë: motorët, metalet, plastikët, bateritë, vajrat, filtrat dhe pjesët e tjera që mund të riciklohen.

Pjesët që përmbajnë substanca të rrezikshme (p.sh. vajra, karburant, lëngje ftohëse, bateri) largohen me kujdes dhe ruhen në enë të mbyllura dhe të etiketuar, për trajtim të mëtejshëm ose dorëzim te operatorë të autorizuar.

Magazinimi i përkohshëm

Mbeturinat ruhen në zona të veçanta të objektit sipas kategorisë dhe natyrës së tyre:

- **Mbeturinat metalike** grumbullohen, pastrohen nga ndotësit (vaj, plastikë, goma) dhe ruhen në hapësira të mbuluara përpara se t’i nënshtrohen procesit të presimit.
- **Vajrat e përdorura** magazinohen në rezervuarë të mbyllur, të vendosur mbi platforma të papërshkueshme për të parandaluar derdhje apo infiltrime në tokë.
- **Mbeturinat e rrezikshme** (bateri, mbetje kimike) ruhen në kontejnerë hermetikë dhe të etiketuar, në përputhje me kërkesat ligjore.
- **Mbeturinat inerte** nga ndërtimi dhe demolimi depozitohen në hapësira të ndara për riciklim ose transport në deponi të miratuara.

Trajtimi dhe përpunimi i mbeturinave

Proceset kryesore të trajtimit në qendër përfshijnë:

- **Ndarjen mekanike dhe seleksionimin** e materialeve të riciklueshme si metale, plastikë, dhe qelq.
- **Presimin dhe paketimin** e metaleve për transport të mëtejshëm drejt kompanive për përpunim final.
- **Dekontaminimin** e mbetjeve që përmbajnë substanca të rrezikshme përpara dorëzimit për asgjësim.

- **Përpunimin e vajrave të përdorura** përmes filtrimit dhe grumbullimit në kontejnerë të standardizuar.

Në rastet kur mbetjet nuk mund të trajtohen brenda kapaciteteve të kompanisë (si hiri nga djegia ose mbetje të rënda toksike), ato dorëzohen për deponim final në **deponi të licencuara** të operatorëve të tjerë.

Masat për mbrojtjen e mjedisit

Në fazën operative, zbatohen masa parandaluese për minimizimin e ndikimeve mjedisore:

- Menaxhimi i ujërave të ndotura përmes ndarjes nga ujërat atmosferike dhe trajtimit në gropa septike ose impiante përkatëse.
- Mbjellja e gjelbërimit në perimetrin e objektit për reduktim të ndikimeve vizuale dhe rritje të cilësisë së ajrit.
- **Platforma e pa përshkueshme nda ujit**, në zonat e ngarkim-shkarkimit dhe ruajtjes së vajrave për të parandaluar ndotjen e tokës.

Monitorimi, siguria dhe kontrolli i cilësisë

Kompanisë ju është bere me dije se duhet bere matje te vazhdueshme monitorimi për cilësinë e ajrit, ujit dhe zhurmës.

Kryhen analiza periodike të mbetjeve për të verifikuar përputhjen me standardet mjedisore. Çdo sasi mbeturinash evidentohet në regjistrat përkatës, ku përfshihen: lloji, sasia, origjina, mënyra e trajtimit dhe destinacioni final.

Punonjësit janë të pajisur me pajisje personale mbrojtëse (PPE) dhe trajnohen rregullisht për menaxhimin e mbetjeve të rrezikshme dhe procedurat emergjente.

Transporti i sigurt i mbeturinave

Transporti realizohet me mjete të licencuara, të përshtatura për llojin e mbeturinave. Ngarkimi, sigurimi dhe shkarkimi bëhen në mënyrë të kontrolluar, për të shmangur derdhjet apo dëmtimet gjatë transportit.

Për çdo ngarkesë shoqërohet formulari i transportit të mbeturinave, në përputhje me kërkesat ligjore për gjurmueshmëri.

Në përfundim, faza operative e Rec-Kos Sh.p.k. është ndërtuar mbi parimet e riciklimit, rikuperimit dhe trajtimit të qëndrueshëm të mbeturinave, duke garantuar mbrojtje të mjedisit, siguri për punonjësit dhe përmbushje të plotë të standardeve ligjore dhe teknike në fuqi.

d) Makineritë e Punës dhe Përpunimit:



Figura 11. Procesi i punës se presës për prerjen e metaleve



Figura 12 Krijim i dangjeve



Figura 13 Krijimi i dangjeve pas çmontimit të makinave



Figura 14 Makinë për bluarjen e mbeturinave metalike



Figura 15. Materialet pas procesit te punës



Figura 16 Grumbullimi i materialeve



Figura 17 palëtimi i llojeve të ndryshme të materialeve



Figura 18. Paketimi i materialeve



Figura 19. Transporti i materialeve me kamion

e) Përshkrimi i detajuar i procesit teknologjik në kompaninë “Rec Kos”

Sh.p.k.

Qendra e Grumbullimit, Çmontimit dhe Përpunimit të Automjeteve të Mbetura dhe Mbeturinave Metalike për Qëllime Riciklimi

Proceset teknologjike në “Rec Kos” Sh.p.k. zhvillohen sipas llojit të mbetjeve dhe kodit përkatës të Katalogut Shtetëror të Mbeturinave. Çdo mbetje i nënshtrohet procedurave të veçanta të **grumbullimit, klasifikimit, çmontimit, përpunimit dhe riciklimit**, në përputhje me standardet mjedisore dhe të sigurisë.

Më poshtë paraqiten shkurt proceset për secilin kod mbeturine të cilat i posedon në pelqimin paraprak:

Kodi CER	Emërtimi i mbeturinës	Përshkrimi i procesit teknologjik
15 01 02	Ambalazhe plastike	Grumbullohen, pastrohen nga ndotjet, seleksionohen sipas llojit të plastikës (PET, HDPE, PP) dhe shtypen në balë për transport në linja riciklimi.
15 01 04	Ambalazhe metalike	Seleksionohen sipas përbërjes (alumini ose hekuri), pastrohen nga mbetjet organike dhe presohen në balë për riciklim në furrat metalurgjike.
15 01 05	Ambalazhe të përbëra	Ndarje mekanike për përbërësit (plastikë, letër, alumin). Pjesët që mund të riciklohen dërgohen në linjat përkatëse, pjesa e mbetur dërgohet për asgjësim.
16 01 03	Goma të vjetra	Pastrohen, ndahen nga felget metalike dhe dërgohen për copëtim ose riciklim në linjën e re për përpunimin e gomave.
16 01 04*	Automjete të vjetra	Çmontohen pjesët kryesore (motori, bateritë, vajrat, filtrat, metalet). Pjesët e rrezikshme hiqen dhe dërgohen për trajtim të veçantë; metali përpunohet për riciklim.
16 01 06	Automjete jashtë përdorimit pa lëngje apo përbërës të rrezikshëm	Çmontohen për ndarje të materialeve metalike, plastikës dhe qelqit. Komponentët e riciklueshëm presohen dhe paketohen për transport.
16 02 09*	Transformatorë dhe kondensatorë me PCB	Identifikohen dhe trajtohen në mënyrë të kontrolluar. PCB-të neutralizohen dhe dërgohen për asgjësim të operatorëve të licencuar. Pjesët metalike riciklohen.
16 02 12*	Pajisje me përmbajtje asbesti të lirë	Izolohen në zona të mbyllura, hiqen materialet me asbest me mjete mbrojtëse, paketohen në qese hermetike dhe dërgohen për deponim të specializuar.
16 06 01*	Bateri plumbi	Ruhen në kontejnerë rezistentë, ndahet plumbi për rikuperim dhe elektroliti neutralizohet kimikisht përpara dërgimit në impiant riciklimi.

16 06 05	Bateri dhe akumulatorë të tjerë	Klasifikohen sipas përbërjes (Ni-Cd, Li-ion etj.), pastrohen dhe dërgohen për përpunim në qendrat partnere për rikuperim metalesh.
16 08 01	Katalizatorë të harxhuar me metale të çmuara	Copëtohen dhe përgatiten për nxjerrje të platinës, paladiumit apo rodiumit në impiante të specializuara jashtë vendit.
17 02 03	Plastika	Ndarje mekanike nga materialet tjera, pastrohen, copëtohen dhe presohen në balë për dërgim në fabrikat e riciklimit plastik.
17 04 01	Bakri, bronzi, tunxhi	Seleksionohen, pastrohen nga ndotjet, copëtohen dhe presohen në balë për dërgim në furra shkrirjeje për rikuperim.
17 04 02	Alumini	Copëtohet, ndahet nga elementët e tjerë, pastrohet dhe presohen në blloqe për eksport ose riciklim lokal.
17 04 03	Plumbi	Grumbullohet nga burime të sigurta, pastrohet dhe dërgohet në impiante të licencuara për shkrirje dhe rikuperim.
17 04 04	Zinku	Përpunohet për ndarje nga përzierjet metalike, presim mekanik dhe paketim për riciklim industrial.
17 04 05	Hekuri dhe çeliku	Seleksionohen përmes magnetëve industrialë, pastrohen, copëtohen dhe presohen në balë për transport në furra riciklimi.
20 01 23*	Pajisje që përmbajnë klorofluorokarbonë (CFC)	Çmontohen me kujdes, hiqet gazit ftohës CFC në pajisje të mbyllura, dërgohet për neutralizim. Pjesët metalike dhe plastike riciklohen.

Procesi teknologjik në “Rec Kos” Sh.p.k. është ndërtuar mbi **parimin e ekonomisë rrethore**, ku çdo lloj mbetjeje trajtohet në mënyrë që të rikuperohen sa më shumë materiale të vlefshme dhe të minimizohet ndikimi mjedisor. Kompania zbaton **standarde të rrepta të sigurisë**, përdor **platforma te papërshkueshme, filtra pluhuri dhe gazesh**, dhe siguron **gjurmueshmëri të plotë për çdo mbetje**, nga pranimi deri në trajtimin final.

f) Përshkrimi i detajuar i procesit teknologjik për kodet shitesë të kërkuara nga kompania “Rec Kos” Sh.p.k.

Qendra e Grumbullimit, Çmontimit dhe Përpunimit të Automjeteve të Mbetura dhe të Mbeturinave për Qëllime Riciklimi

Proceset e propozuara për zgjerimin e kodeve mbështeten në teknologjitë ekzistuese të kompanisë, të cilat bazohen në grumbullim të kontrolluar, klasifikim sipas përbërjes, përpunim mekanik, trajtim paraprak dhe riciklim, duke siguruar që çdo mbetje të përpunohet në mënyrë të sigurt dhe në përputhje me legjislacionin mjedisor.

Kodi CER	Emërtimi i mbeturinës	Përshkrimi i procesit teknologjik
02 01 10	Mbeturina metalike	Mblidhen, pastrohen dhe seleksionohen sipas llojit të metalit. Materialet e pastra presohen në balë për riciklim në furra metalurgjike.
04 01 09	Mbeturina nga veshjet dhe proceset përfundimtare	Ndarje e materialeve tekstile dhe fibrave; pjesët e ripërdorshme dërgohen për riciklim, pjesa tjetër për djegie të kontrolluar.
04 02 09	Mbeturina nga materiale të përziera (tekstil + plastikë)	Përmes ndarjes mekanike veçohen përbërësit tekstilë dhe plastikë; plastika shtypet në balë, tekstili dërgohet për përpunim energjetik.
07 02 13	Mbeturina plastike	Copëtohen, lahen dhe përgatiten për riciklim mekanik; krijohen granula ose balë për eksport.
08 01 11*	Mbeturina ngjyrash dhe llaqeve që përmbajnë tretës organikë	Mblidhen në kontejnerë të mbyllur, neutralizohen kimikisht dhe dërgohen për asgjësim në impiante të licencuara.
08 01 12	Mbeturina tjera të ngjyrave dhe llaqeve	Pastrohen nga paketimet, thahen dhe dërgohen për djegie të sigurt ose riciklim kimik.
10 01 01	Hiri nga fundi, llum dhe pluhur kaldajash	Ftohje, sitje dhe analizë laboratorike; fraksionet e përshtatshme përdoren si materiale ndërtimore inerte.
10 01 02	Hiri fluturues nga thëngjilli	Stabilizohet përmes përzierjes me çimento ose materiale inerte dhe deponohet në zona të veçanta të kontrolluara.
10 03 02	Skrapet e anodave	Copëtohen dhe dërgohen për shkrirje për rikuperim të bakrit ose aluminit.
10 03 05	Mbeturina nga alumini	Ndarje e pjesëve të pastra nga oksidet, tharje dhe përgatitje për shkrirje.
10 03 20	Pluhur nga tymi i oxhakut	Filtrim për ndarjen e grimcave metalike dhe deponim të mbetjeve të mbetura në vende të miratuara.
10 04 01*	Llumrat nga prodhimi primar dhe sekondar	Dekantim, tharje dhe dërgim i mbetjeve të ngurta për rikuperim metalik.

10 06 01	Llumra metalike	Filtrimi dhe tharja; pjesa e ngurtë dërgohet për shkrirje.
10 09 03	Llumra nga furra për shkrirje	Ftohje dhe përzgjedhje për ndarje të oksideve metalike për riciklim.
10 10 03	Llumra nga furra për shkrirje	Proces identik me 10 09 03 – tharje dhe përgatitje për rikuperim.
10 12 01	Mbeturina nga përgatitja e përzierjes para procesit termik	Përzienje e mbetjeve për stabilizim dhe dërgim në deponi inerte.
10 12 06	Kallëpe të përdorura	Pastrim mekanik dhe ndarje nga skoriet; materiali qeramik ripërdoret si agregat.
10 12 08	Mbeturina qeramike, tullave, pllakave	Copëtim, grirje dhe përdorim si mbushës në ndërtim.
10 13 01	Mbeturina nga përgatitja e përzierjeve termike	Ndarje mekanike e fraksioneve dhe deponim ose riciklim si inert.
10 13 14	Mbeturina të betonit dhe llumra betoni	Copëtim, pastrim nga papastërtitë dhe përdorim për mbushje teknike.
11 05 01	Zinku i rëndë	Filtrim dhe tharje përpara dërgimit për shkrirje në furra riciklimi.
11 05 02	Hiri i zinkut	Ndarje e fraksioneve me përmbajtje metalike dhe deponim të pjesës inerte.
12 01 13	Mbeturina nga saldimi	Grumbullim i skorieve dhe pluhurit metalik për rikuperim ose deponim.
13 01 09*	Vajra hidraulike të kloruara me bazë minerale	Ruajtje në tanka hermetikë, filtrimi dhe dorëzim për rigjenerim energjetik.
13 01 10*	Vajra hidraulike të pakloruara	Filtrohen dhe dërgohen për riciklim ose rigjenerim të bazës vajore.
13 01 11*	Vajra hidraulike sintetike	Trajtim për ndarjen e ujit dhe impurteteve; dërgim në impiante rigjenerimi.
13 01 12*	Vajra hidraulike lehtësisht biodegradueshme	Filtrimi dhe përdorim i përsëritur ose dërgim për rigjenerim.
13 01 13*	Vajra të tjerë hidraulikë	Si më sipër – grumbullim, ruajtje e sigurt dhe rigjenerim.
13 02 04*	Vajra motori/ingranazhesh të kloruara	Ndarje nga uji dhe dërgim për djegie energjetike.
13 02 05*	Vajra motori të pakloruara	Filtrimi, dekantimi dhe dërgim për rigjenerim ose riciklim.
13 02 06*	Vajra sintetike motori	Pastrim nga grimcat metalike dhe përdorim për përzierje vajrash teknike.
13 02 07*	Vajra biodegradueshme motori	Grumbullim dhe filtrimi përpara përdorimit të dytë ose rigjenerimit.
13 02 08*	Vajra të tjerë motori	Proces standard: filtrimi dhe dërgim për asgjësim ose rigjenerim.
13 05 06*	Vajra nga separatorët ujë/vaj	Filtrohen dhe ndahen për riciklim të pjesës vajore; mbetjet neutralizohen.

13 05 07*	Ujë me vaj nga separatorët ujë/vaj	Ndarje fiziko-kimike për heqjen e vajit dhe pastrim të ujit.
15 01 01	Ambalazhe letre dhe kartoni	Ndarje nga mbetjet e tjera, presim dhe riciklim në industri të letrës.
15 01 03	Ambalazhe druri	Copëtim dhe përdorim për prodhim peletësh ose energji alternative.
15 01 07	Ambalazhe qelqi	Larje, ndarje sipas ngjyrës dhe shtypje në grimca për riciklim.
15 01 09	Ambalazh tekstili	Riciklim për prodhime tekstile ose përdorim energjetik.
15 01 11*	Ambalazhe metalike me materiale të rrezikshme	Dekontaminim, pastrim dhe dërgim për riciklim metalik.
15 02 02*	Absorbues dhe filtra të kontaminuar	Paketim hermetik dhe dërgim për djegie të kontrolluar.
16 01 07*	Filtera vaji	Nxjerrje e vajit të mbetur dhe riciklim i trupit metalik.
16 01 09*	Komponentë me PCB	Paketim i sigurt dhe dërgim në trajtim special jashtë vendit.
16 01 13*	Lëngje frenash	Grumbullim, neutralizim dhe dërgim për trajtim kimik.
16 01 17	Metale ferore	Ndarje me magnet, pastrim dhe presim për dërgim në riciklim.
16 01 18	Metale jo ferore	Përzgjedhje manuale, presim dhe paketim për eksport.
16 01 19	Plastika	Copëtim, larje dhe përgatitje për riciklim.
16 01 20	Qelqi	Ndarje nga mbeturinat e tjera dhe riciklim në industri qelqit.
17 01 01	Betoni	Copëtim dhe përdorim si agregat për mbushje.
17 01 02	Tulla	Riciklim përmes copëtimit dhe përdorimit si agregat.
17 01 03	Tjegulla dhe qeramika	Grirje dhe përdorim në ndërtim rrugësh.
17 01 07	Përzierje betoni/tullash/qeramike	Ndarje mekanike dhe përdorim si material ndërtimor.
17 02 02	Qelqi	Larje, copëtim dhe riciklim.
17 06 01*	Materiale izoluese me asbest	Paketim hermetik dhe dërgim për deponim të specializuar.
17 06 03*	Materiale izolimi me substanca të rrezikshme	Izolim dhe asgjësim i kontrolluar.
17 06 04	Materiale izolimi të zakonshme	Riciklim ose deponim si inert.
17 06 05*	Materiale ndërtimi me asbest	Paketim dhe dërgim për deponim të licencuar.
17 08 02	Gips	Riciklim për prodhim përbërjesh ndërtimore.
17 09 04	Mbeturina të përziera ndërtimi dhe demolimi	Ndarje mekanike e fraksioneve ricikluese dhe presim për riciklim.

19 10 01	Mbeturina hekuri dhe çeliku	Presim dhe paketim për dërgim në furra riciklimi.
19 12 01	Letër dhe karton	Seleksionim dhe presim për riciklim në fabrikat e letrës.
19 12 02	Metale ferore	Ndarje me magnet, pastrim dhe presim.
19 12 03	Metale jo-ferore	Përzgjedhje, pastrim dhe eksport për shkrirje.
19 12 04	Plastike dhe gomë	Copëtim, larje dhe paketim për riciklim.
19 12 05	Qelqi	Copëtim dhe riciklim në industri të qelqit.
20 01 01	Letër dhe karton	Presim dhe dërgim për riciklim.
20 01 02	Qelqi	Larje, copëtim dhe riciklim.
20 01 11	Tekstili	Riciklim ose ripërdorim industrial.
20 01 33*	Bateri dhe akumulatorë me përbërje të rrezikshme	Ruajtje në enë të mbyllura dhe dërgim për rikuperim të metaleve.
20 01 34	Bateri dhe akumulatorë të tjerë	Grumbullim dhe dërgim për riciklim elektrokimik.
20 01 36	Pajisje elektrike/elektronike	Çmontim dhe ndarje e përbërësve për riciklim.
20 01 39	Plastika	Larje, copëtim dhe presim për riciklim.
20 01 40	Metalet	Pastrim dhe presim për shkrirje.
20 01 41	Mbeturina nga pastrimi i oxhaqeve	Grumbullim, ftohje dhe deponim i kontrolluar.
20 03 01	Mbeturina të përziera komunale	Seleksionim i fraksioneve ricikluese dhe dërgim në linjat përkatëse.
20 03 02	Mbeturina nga tregjet	Grumbullim, ndarje dhe riciklim i përbërësve të vlefshëm.
20 03 04	Llumra nga tanku septik	Dekantim, tharje dhe dërgim në impiant biologjik.
20 03 99	Mbeturina komunale të paspecifikuara ndryshe	Klasifikim shtesë dhe dërgim për riciklim ose deponim tek kompanite e Licecuara.

Kjo strukturë paraqet qartë secilin **kod individual** dhe mënyrën se si “Rec Kos” do ta **trajtojë teknikisht dhe në mënyrë të sigurt** gjatë fazës operative, sipas kërkesave të zgjerimit të lejes mjedisore.

g) Përlllogaritja sipas llojit dhe sasisë të mbetjeve dhe emetimeve të pritura gjate fazës së operimit

✚ Parimet e llogaritjes

- Identifikohet rrjedha e mbetjeve sipas kodit. Regjistrohet sasia vjetore në ton.
- Për çdo rrjedhë përcaktohet destinacioni. Riciklim. Trajtim i veçantë. Dorëzim te operatorë të tjerë. Deponim. Djegie.
- Emetimet llogariten me faktorë tipikë për aktivitetin përkatës. Shredding dhe ngarkim shkarkim për pluhur. Trajtim vajrash për VOC. Transport për CO₂. Incinerim për NO_x, SO₂, HCl, PM, metale dhe PCDD F. Deponim për CH₄.
- Zbatohen efikasitetet e pajisjeve të kontrollit. Filtra qese për pluhur. Kule gëlqere për acide. Karbon aktiv për metale të rënda dhe dioksina. Kapak dhe kapje gazi për deponi.
- Jepen rezultatet vjetore dhe krahasohen me kufijtë ligjorë të lejes.

✚ Ajri

- Motorët e automjeteve të transportit dhe forkliftët. CO. NO_x. Hidrokarbure të pa djegura. SO₂.
- Proceset mekanike. Sharrim. Copëtim. Presim. Pluhur i pezulluar PM.
- Trajtimi i vajrave dhe solventeve. VOC dhe erë.
- Incinerimi kur ka mbetje që kërkojnë djegie. NO_x. SO₂. HCl. HF. CO. PM. metale të rënda. PCDD F.

Transporti. $CO_2_transport = sasia\ e\ transportuar\ në\ ton\ shumëzim\ litra\ naftë\ për\ ton\ shumëzim\ faktor\ CO_2\ për\ litër.$

Pluhuri nga operimet. $PM_vit = sasia\ në\ ton\ shumëzim\ faktor\ pluhuri\ për\ ton\ shumëzim\ një\ minus\ efikasiteti\ i\ filtrit.$

VOC nga vajrat. $VOC_vit = sasia\ në\ ton\ shumëzim\ faktor\ VOC\ për\ ton.$

Incinerimi. Për çdo ndotës p. $Emisioni_p = sasia\ e\ djegur\ në\ ton\ shumëzim\ faktori\ i\ emisionit\ p\ shumëzim\ një\ minus\ efikasiteti\ i\ mundshëm\ i\ reduktimit.$

✚ Masa të zbatuara

Ventilim i kontrolluar me filtër në sallat ku trajtohen vajra dhe mbetje me erë.

Trajtim acid në reaktor me gëlqere kur ka gazra acidik nga djegia.

Karbon aktiv për metale të rënda dhe dioksina.

Mirëmbajtje periodike e flotës për ulje të emetimeve nga motorët.

Ajrim natyral përmes dritareve dhe rrugë ajrimi të projektuara në dy anë të objektit.

Monitorim i erërave në pikë daljeje dhe mbajtje e regjistrave.

Uji

Uji sanitar nga ujësjellësi.

Uji procesi nga pusi vetanak kur nevojitet pastrim i materialeve.

Ujërat e kontaktit nga zona e ngarkim shkarkimit dhe trajtimit të vajrave.

Ujë_procesi = sasia e rrjedhës që lahet në ton shumëzim konsum uji për ton.

Llum nga separatorët ujë vaj = sasia në ton shumëzim faktor llumi në kg për ton pjesëtuar me një mijë.

Uji i trajtuar regjistrohet me matës. Shkarkimi bëhet në basene neutralizimi. PH dhe parametra të tjerë maten para shkarkimit.

Masa të zbatuara

Platforma e papërshkueshme dhe kanalizim i mbyllur për ujëra të ndotura.

Separatorë ujë vaj. Basene neutralizimi dhe sedimentimi.

Ndarje e plotë nga ujërat atmosferike të pastra.

Analiza periodike të ujit të shkarkuar dhe të pusit.

Dheu dhe toka

Humbje e lehtë sipërfaqeje për infrastrukturë.

Rrezik i derdhjes së naftës dhe vajrave gjatë operimit dhe transportit.

Deponime të përkohshme inerte dhe hiri kur ky prodhohet nga djegia.

Sasitë e derdhjeve llogariten nga regjistri i incidenteve.

Hiri i poshtëm dhe pluhuri i filtrave llogariten si përqindje ndaj mbetjeve të djegura.

Volumi i tokës së gërmuar dhe i mbushjes dokumentohet me akte teknike.

Masa të zbatuara

Paleta dhe vaska sekuestruese nën rezervuarë dhe fuçi.

Komplete absorbuesish dhe procedura të menjëhershme pastrimi.

Magazinin i mbyllur i hirit dhe dorëzim te operatorë të licencuar.

Zhurma

Burimi kryesor është lëvizja e mjeteve dhe pajisjet mekanike.

Zhurma vlerësohet me nivele në kufirin e pronës gjatë ditës dhe natës.

Masat përfshijnë mirëmbajtje të motorëve, kufizim të punimeve me zhurmë në orar ditor, mbyllje e dyerve gjatë copëtimit, ekrane akustike nëse duhen.

Dridhjet

Dridhjet burojnë nga makineritë dhe lëvizjet e ngarkesave të mëdha.

Nivelet janë të ulëta dhe lokale. Makineritë vendosen mbi baza elastike. Rrugët e brendshme mirëmbahen.

Nuk pritet ndikim në struktura jashtë parcelës.

Drita, nxehtësia, rrezatimi

Ndriçim LED ekonomik.

Shfrytëzim i rrezatimit diellor për kursim energjie në periudha të përshtatshme.

Nuk përdoren burime rrezatimi jonizues. Monitorohet vetëm detektori i rrezatimit në hyrje për siguri materiale.

Flora dhe fauna

Ndikimi është minimal sepse veprimtaria është në zonë industriale.

Perimetri ka gjelbërim për ulje pluhuri dhe ekranim vizual.

Ujërat e pastruara shkarkohen vetëm pasi përmbushin kriteret për të mos dëmtuar habitate.

Ndikimet sociale dhe ekonomike

Aktiviteti nuk pritet të ketë ndikim negativ tek komuniteti.

Gjenerohen vende pune dhe rritet riciklimi lokal.

Transporti organizohet në orare që shmangin pikat e ngarkuara dhe përdoren mjete në gjendje të mirë.

Masat që e mbajnë ndikimin të ulët

Platforma papërshkueshme dhe separatorë ujë vaj me basene neutralizimi.

Filtra qese në linjat e praftimit dhe presimit.

Karbon aktiv në dalje gazi kur kërkohet.

Mirëmbajtje e rreptë e flotës dhe pajisjeve.

Regjistra gjurmueshmërie për çdo rrjedhë mbetjesh dhe analizat përkatëse.

4. PËRSHKRIMI I ALTERNATIVAVE TË ARSYESHME

Qendra e Grumbullimit, Çmontimit dhe Përpunimit të Automjeteve të Mbetura dhe të Mbeturinave për Qëllime Riciklimi – “Rec Kos” Sh.p.k., Zona Industriale, Z.K. Sankoc, Komuna Glllogoc

Vlerësimi i alternativave të arsyeshme për ndërtimin dhe operimin e kësaj qendre ka për qëllim të analizojë opsionet më të përshtatshme nga aspekti mjedisor, teknik dhe socio-ekonomik, duke garantuar zhvillim të qëndrueshëm dhe ndikim minimal në mjedis.

- **Alternativa 1 – Zbatimi i projektit në lokacionin ekzistues (Alternativa e zgjedhur)**

Kjo alternativë parasheh zhvillimin e qendrës në **zonën industriale të Fshatit Sankocit**, ku “Rec Kos” Sh.p.k. tashmë ka infrastrukturën bazë, qasje të lehtë në rrugë transporti dhe lidhje me rrjetet energjetike e ujësjellësin publik.

Ky lokacion është i destinuar me planifikim hapësinor për veprimtari industriale dhe nuk kufizohet me zona të banuara ose me vlera të mbrojtura natyrore.

Avantazhet kryesore janë:

- ekzistenca e infrastrukturës rrugore dhe energjetike,
- minimizimi i ndërhyrjeve në tokë të reja bujqësore,
- përqendrim i aktiviteteve të ngjashme industriale në një zonë të kontrolluar,
- monitorim i lehtë i ndotjeve të mundshme falë sistemeve të instaluar të trajtimit dhe kontrollit.

Ky opsion është më i përshtatshmi teknikisht dhe ekonomikisht, pasi e përdor hapësirën ekzistuese të përshtatur për menaxhim mbeturinash dhe ofron mundësi zgjerimi pa ndikuar në mjedisin përreth.

- **Alternativa 2 – Zhvendosja në lokacion tjetër**

Kjo alternativë do të nënkuptonte ndërtimin e një qendre të re në një zonë tjetër jashtë Sankocit, për shembull në periferi të një zone rurale.

Megjithëse do të mund të reduktonte ndikimet e zhurmës apo trafikut në zonën aktuale, kjo alternativë sjell pasoja të tjera:

- nevojë për shfrytëzim të tokës bujqësore dhe humbje të sipërfaqeve pjellore;
- investime shtesë për infrastrukturë (rrugë, ujësjellës, energji elektrike);
- rrezik më të madh për ndotje të ujërave nëntokësore nëse nuk ekziston rrjet kanalizimi industrial.

Për këto arsye, alternativa e zhvendosjes nuk është e arsyeshme, pasi do të rrisë kostot dhe ndikimin në mjedis pa ofruar përfitime të konsiderueshme.

- **Alternativa 3 – Mos-zbatimi i projektit (Opsioni “zero”)**

Nëse projekti nuk do të realizohet, mbeturinat metalike, automjetet e braktisura, bateritë dhe vajrat e përdorura do të vazhdonin të menaxhoheshin në mënyrë të paorganizuar, duke shkaktuar:

- ndotje të ajrit, ujit dhe tokës për shkak të deponive të paautorizuara;
- humbje të materialeve të vlefshme që mund të riciklohen;
- rritje të rrezikut për shëndetin publik.

Ky opsion nuk është i qëndrueshëm as nga aspekti mjedisor, as nga ai ekonomik, dhe bie ndesh me objektivat kombëtare për menaxhimin e qëndrueshëm të mbeturinave.

- **Vlerësimi përfundimtar**

Pas analizës së të gjitha alternativave, lokacioni ekzistues në zonën industriale të Sankocit rezulton si zgjedhja më e arsyeshme për zhvillimin e Qendrës së Grumbullimit, Çmontimit dhe Përpunimit të Mbeturinave nga kompania **“Rec Kos” Sh.p.k.**

- siguron efikasitet teknik dhe ekonomik,
- minimizon ndikimin mjedisor,
- përputhet me destinimin urbanistik dhe planin hapësinor të komunës së Gllogocit,
- dhe kontribuon drejtpërdrejt në rritjen e kapaciteteve të përpunimit dhe perkatitjes së produktit për riciklim në Kosovë dhe zbatimin e parimeve të ekonomisë qarkulluese.

5. GJENDJA AKTUALE E MJEDISIT

Ndotja e mjedisit është rezultat i shumë faktorëve si: industria, ndërtimet ilegale, infrastruktura joadekuate, shtimi i numrit të automjeteve, importimi i automjeteve të vjetruara në Kosovë, importi i vajrave dhe derivateve të kualitetit të dobët (me sasi të lartë të sulfurit), deponimi joadekuat i tyre, ndotja e ujërave sipërfaqësore dhe nëntokësore, mungesa e trajtimit të ujërave të zeza, prerja e pakontrolluar e pyjeve, akumulimi i plehrave urbane si pasojë e menaxhimit të dobët, mungesa së riciklimit, etj. Duke konsideruar prezencën e shumicës së faktorëve të lartpërmendur, gjendja e mjedisit në komunën e Gllogocit nuk mund të konsiderohet në nivel të kënaqshëm. Industria e prodhimit të metaleve (NeWCo Feronikeli) është një nga industritë me ndikim më të madh mjedisor në Kosovë, edhe pse vërehet ulje e emisioneve që vijnë si rezultat i aktivitetit të tyre. Sektori i transportit dhe infrastrukturës së tij është një ndër sektorët që ka ndikim mjaft negativ në gjendjen e mjedisit ngase ndikon në fragmentimin dhe degradimin e habitateve (biodiversitetit), ndryshimin e peizazhit, shfrytëzimin e tokës dhe trashëgiminë kulturore. Kjo gjendje e kërcënon mjedisin duke shkaktuar ndotjen e ujit, ujërave nëntokësorë, ajrit dhe dheut. Si pasojë kemi dëmtimin e resurseve natyrore dhe humbje të tokës bujqësore. Shfrytëzimi joracional dhe pa kriterë të ujit, tokës si dhe pyjeve është një tjetër çështje që duhet të konsiderohet si çështje serioze në të ardhmen. Është përgjegjësi komunale që të mbrojë dhe ruaj mjedisin natyror dhe jetësor (urban dhe rural) nga dëmtimi, degradimi apo ndotja si pasojë e veprimtarisë njerëzore ose të ndikimit natyror.

5.1 Flora dhe Fauna

Komuna e Gllogocit ka një pozite të mirë gjeografike me një hidrografi të pasur dhe shtrihe mjaftë të madhe gjeografike, e cila përfshinë zonat mesatarisht të larta dhe zonal e ulëta të terrenit. Në këtë komunë, sa i përket biodiversitetit lidhur me llojet e bimëve këtu kemi mjaft larmishmerie të bimëve nga ato barishtore njëvjeçare deri te ato shumëvjeçare dhe drunore apo brezat të pyjeve. Nga brezi i shpërdhit me qarr shkon deri te brezi i ahut dhe shkozës. Brezi i pyjeve të shpërdhit me qarr bungut janë brezi me i dëmtuar nga faktori njeri. Ndërkaq në zonal e ulëta kemi vegjetacionin e livadheve me shoqërime mjaftë të mëdha dhe të begatshme me lloje. Po ashtu në këto zona të gjejmë edhe vegjetacionin përgjatë rrugëve dhe vendbanimeve por, edhe barërat e këqija të cilat gjenden në tokat djerrina, në kufi të parcelave dhënë afërsi të gjerdheve. Toka ku është ndërtuar qendra e grumbullimit, çmontimit dhe përpunimit të automjeteve mbeturinë, përpunimit të mbeturinave metalike për qëllime riciklimi,

grumbullimin e vajrave të përdorura, mbeturinave nga pajisjet elektrike dhe elektronike, mbeturinave nga konstruktimi dhe demolimi, mbeturinat komunale si dhe mbeturinat e paspecifikuara ndryshe ka një florë dhe faune të mire, por në rrethinën e qendrës ka edhe shumë llojshmëri të ndryshme të bizneseve.

5.2 Hidrografia

Lumi kryesor që kalon nëpër komunën e Gllogocit është Drenica, e cila është degë e majtë e lumit Sitnica dhe i takon pellgut të Ibrit. Ajo buron në Bretenc të mali Cërralevë. Drenica që nga Gllogoci e deri në Bardh i Madh, hyn në një pjesë të ngushtë, duke marrë pamjen e një gryke. Në këtë pjesë të lumit pjerrtësia është më e madhe, gjerësinë më të madhe (10 m) dhe me pjerrtësi të butë derdhet në Sitnicë. Prurja mesatare e lumit Drenica në Sitnicë është 2,0 m³/s. Drenica ka dhe degëzimet e veta siç është Verbofc. Në territorin e komunës së Gllogocit ndodhet edhe Liqeni i Vasilevës. Gjithashtu, në territor të komunës gjendet edhe burimi i ujit mineral në Poklek me temperaturë 13.0°C, pH 6.3., rrjedhje 1.00l/sec dhe mineralizim 3.52 si dhe ai në Vërboc, lagjja Istog. Sipërfaqen e tokës pjellore të Luginës së Drenicës e mbulon sistemi i ujitjes “Ibër-Lepenc”. Klima - Kushtet klimatike janë mjaft të përshtatshme. Rajoni ka një klimë të mesme kontinentale me dimra të ftohtë dhe verë të ngrohtë me ndikime të klimës mesdhetare. Kjo vënie nga pozita e komunës në mes të Rrafshit të Kosovës dhe atij të Dukagjinit. Rrafshi i Dukagjinit ka klimë me ndikime mesdhetare nga deti Adriatik, kurse ai i Kosovës ka klimë kryesisht kontinentale. Temperatura mesatare vjetore është 10.6 °C, ku muaji më i ftohtë është janari me 0.8°C, kurse muaji më i ngrohtë është korriku me 20.6°C. Sasia mesatare e të reshurave është afër 670 mm, kurse në sezonin e vegjetacionit (prej muajit të IV-IX) afër 330 mm.



Figura 20. Rrjeti Hidrografik i Komunës së Glogoci

6. IDENTIFIKIMI DHE PËRSHKRIMI I NDIKIMEVE NË MJEDIS

Identifikimi dhe përshkrimi i ndikimeve në mjedis përfshin analizimin e mënyrave se si aktivitetet e ndryshme industriale në qendrën e grumbullimit, çmontimit dhe përpunimit të automjeteve mbeturinë, përpunimit të mbeturinave metalike për qëllime riciklimi, grumbullimin e vajrave të përdorura, mbeturinave nga pajisjet elektrike dhe elektronike, mbeturinave nga konstruktimi dhe demolimi, mbeturinat komunale si dhe mbeturinat e paspecifikuara ndryshëm, nga kompania "Rec Kos" SH.P.K., mund të ndikojnë në ambient. Duke u bazuar në analizën e ndikimeve të mundshme në mjedis, paraqesim në këtë rast një analizë më të hollësishme të ndikimeve të mundshme në mjedis. Analiza e VNM-së në këtë rast realizohet duke u bazuar në projektin e përfunduar më lart në këtë raport si dhe nga gjendja reale në lokacionin respektivisht zonën ku është ndërtuar objekti të cilin e shfrytëzon kompania "Rec Kos" SH.P.K.. Kjo analizë kryhet me qëllim të vlerësimit të ndikimit në mjedis në dobi të zhvillimit të qëndrueshëm të mjedisit duke mos i cenuar aspektet: kimike-fizike (ndikimet në burimet natyrore dhe degradimi fizik i mjedisit), biologjike-ekologjike (ruajtja e biodiversitetit, ndikimi mbi jetën e gjallë dhe biosferë) dhe socio-ekonomike (ndikimet e përkohshme apo të përhershme pozitive apo negative). Brenda kompleksit janë të instaluar separatorët e vajit, si dhe impianti për trajtimin e ujërave të ndotura teknike, të cilët garantojnë ndarjen e substancave ndotëse para derdhjes në sistemin e kanalizimit. Këto masa teknike e minimizojnë në mënyrë të ndjeshme ndikimin potencial në mjedis, sidomos gjatë operimit të zakonshëm të qendrës.

6.1 Ndikimet në ajër

Gjatë fazës operative të qendrës së grumbullimit, çmontimit dhe përpunimit të automjeteve mbeturinë, përpunimit të mbeturinave metalike për qëllime riciklimi, grumbullimin e vajrave të përdorura, mbeturinave nga pajisjet elektrike dhe elektronike, mbeturinave nga konstruktimi dhe demolimi, mbeturinat komunale si dhe mbeturinat e paspecifikuara ndryshëm, ndikimet në cilësinë e ajrit janë të kufizuara dhe lidhen kryesisht me lëvizjen e automjeteve për transportin e mbeturinave hyrëse dhe dalëse, me procesin e ngarkim-shkarkimit të materialeve metalike dhe automjeteve të çmontuara, si dhe me përdorimin e makinerive ndihmëse si vinça, karroca dhe presa. Objekti nuk kryen asnjë proces termik, djegieje apo trajtimi kimik që mund të prodhojë gazra ndotës si CO₂, NO_x apo SO₂. Burimi kryesor i emetimeve mbetet ai mekanik dhe i përkohshëm. Pluhuri që mund të gjenerohet gjatë

manipulimit të materialeve të thata mbetet i kufizuar brenda perimetrit të qendrës, pasi të gjitha sipërfaqet operative të jashtme janë të asfaltuara ndërsa sipërfaqet e mbuluara janë me beton, dhe pastrohen rregullisht, kryhet spërkatje periodike në periudha të thata dhe materialet ruhen në kontejnerë të mbyllur ose të mbuluar. Falë këtyre masave parandaluese dhe kontrolluese, ndikimi në ajër vlerësohet minimal dhe i kontrolluar, pa rrezik për ndotje difuze jashtë zonës operative të objektit.

6.2 Ndikimet në tokë

Aktivitetet e “Rec Kos” SH.P.K., qendrës së grumbullimit, çmontimit dhe përpunimit të automjeteve mbeturinë, përpunimit të mbeturinave metalike për qëllime riciklimi, grumbullimin e vajrave të përdorura, mbeturinave nga pajisjet elektrike dhe elektronike, mbeturinave nga konstruktimi dhe demolimi, mbeturinat komunale si dhe mbeturinat e paspecifikuara ndryshëm, mund të kenë disa ndikime nëse nuk merren masat e duhura. Keto ndikime janë të kufizuara dhe lidhen vetëm me aktivitetet e zakonshme të operimit brenda hapësirave të qendrës. Të gjitha proceset e grumbullimit, seleksionimit dhe çmontimit të automjeteve zhvillohen mbi sipërfaqe të asfaltuara dhe të papërshkueshme ndaj ujit, të cilat parandalojnë infiltrimin e substancave ndotëse në shtresat e tokës. Mbeturinat metalike, plastike, vajrat e përdorura dhe materialet elektrike depozitohen në kontejnerë të mbyllur, paleta metalike ose rezervuarë të dedikuar, në mënyrë që të shmanget çdo kontakt me tokën. Gjithashtu, kompania ka të instaluar separatorin e vajit dhe sistemin për trajtimin e ujërave të ndotura, gjë që siguron mbrojtje shtesë ndaj ndotjes aksidentale. Në rast rrjedhjesh të mundshme të vajrave apo derivateve, personeli duhet të veprojë sipas procedurave të emergjencës dhe përdor materiale që përthithin vajin e derdhura për neutralizim dhe mbledhje. Në këto kushte, ndikimi në tokë vlerësohet i papërfillshëm, pasi objektet e ndërtuara dhe sipërfaqja operuese e asfaltuar, kontrolli i rreptë teknik dhe menaxhimi i mirë i mbetjeve sigurojnë mbrojtje efektive të mjedisit tokësor dhe parandalojnë ndotjen afatgjatë.

6.3 Ndikimet në ujë

Ndikimet në ujë janë të kontrolluara dhe të kufizuara falë infrastrukturës ekzistuese të objektit, e cila përfshin sistemin e kanalizimit të ndarë për ujërat atmosferike, teknike dhe administratës, separatorin e vajit dhe impiantin për trajtimin e ujërave të ndotura. Ujërat që krijohen gjatë larjes së sipërfaqeve, pastrimit të mjeteve ose proceseve të tjera teknike kalojnë përmes sistemit të grumbullimit dhe më pas trajtohen në impiant, ku ndahen vajrat, sedimentet dhe ndotësit para shkarkimit në rrjetin komunal, gjithashtu edhe ujërat e administratës

trajtohen veçmas, pastaj bashkohen me ujerat tjetër te trajtuar dhe derdhen se bashku ne kanalizimin e fshatit. Falë këtij sistemi, eliminohet rreziku i derdhjeve direkte të substancave ndotëse në mjedis. Po ashtu, sipërfaqet operative janë të asfaltuara dhe të papërshkueshme ndaj ujit, duke parandaluar infiltrimin e ujërave të ndotura në shtresat e tokës dhe ndotjen e ujërave nëntokësore. Për shkak të këtyre masave teknike dhe menaxhuese, ndikimi në cilësinë e ujërave sipërfaqësore dhe nëntokësore vlerësohet minimal dhe brenda kufijve të lejuar ligjorë, pa potencial për ndotje të mjedisit ujqor.

6.4 Ndikimet në peizazh, florë dhe faunë

Ndikimet në peizazh, florë dhe faunë janë të papërfillshme, pasi objekti është i ndërtuar dhe ndodhet brenda një zone të zhvilluar industriale, ku mjedisi natyror është tashmë i transformuar nga aktivitetet ekonomike përreth. Në perimetrin e qendrës nuk ka habitate natyrore, sipërfaqe pyjore apo zona me rëndësi ekologjike që mund të ndikohen nga operimi i objektit. Të gjitha aktivitetet zhvillohen brenda kufijve të ndërtimit ekzistues dhe nuk parashikohet asnjë zgjerim fizik i hapësirave, çka e përjashton çdo ndërhyrje në terren natyror. Peizazhi vizual mbetet i pandryshuar, duke qenë se objekti është pjesë e një kompleksi industrial me infrastrukturë të përshtatur për këtë destinim. Për këto arsye, ndikimi në peizazh, florë dhe faunë vlerësohet i ulët dhe pa pasoja afatgjata në elementet ekologjike apo vizuale të mjedisit përreth.

6.5 Ndikimet në vendbanime dhe popullatë

Hapësira ku është ndërtuar objekti te cilin e shfrytëzon kompania “Rec Kos” SH.P.K. nuk ka ndikim negative në popullatën e zonës pasi që lokacioni ku është bërë ndërtimi është largë vendbanimeve. Por prape ndikimet mund të lidhen me ekspozimin e mundshëm të komunitetit ndaj pluhurit, erërave të pakëndshme, emetimeve të gazrave dhe rrezikut nga aksidentet teknologjike. Nga ana tjetër, projekti sjell ndikime pozitive si hapja e vendeve të reja të punës dhe rritja e ekonomisë lokale.

6.6 Ndikimet nga zhurma

Ndikimet në vendbanime dhe popullatë janë të papërfillshme, pasi objekti ndodhet në zonë industriale të përcaktuar me plane zhvillimore komunale dhe është i pozicionuar në distancë të mjaftueshme nga zonat e banuara. Kjo kompani ndodhet larg vendbanimeve, dhe zhurma me e madhe shkaktohet nga zhurma e shkaktuar nga rruga, magjistralja M9. Operimi i rregullt i impiantit të trajtimit të ujërave, përdorimi i kontejnerëve të mbyllur dhe menaxhimi i

kontrolluar i mbetjeve sigurojnë që nuk ka shpërndarje aromash apo rrjedhje të substancave ndotëse jashtë territorit të objektit. Nga aspekti social dhe ekonomik, prania e kësaj qendre ka ndikim pozitiv, pasi ofron vende pune të qëndrueshme dhe kontribuon në sistemin e menaxhimit të qëndrueshëm të mbeturinave, duke zvogëluar sasinë e tyre që përfundon në deponi. Kompania respekton rregullat e sigurisë në punë dhe masat mbrojtëse ndaj komunitetit, prandaj ndikimi në popullatë vlerësohet minimal dhe nuk paraqet rrezik për shëndetin publik apo mirëqenien e banorëve në zonën përreth.

6.7 Ndikimet në raste të aksidenteve mjedisore

Ndikimet në raste të aksidenteve mjedisore mund të ndodhin vetëm në situata të jashtëzakonshme, si derdhje të vajrave, rrjedhje të lëndëve të rrezikshme, zjarre ose defekte teknike në pajisje. Megjithatë, për shkak të karakterit të kontrolluar të veprimtarisë dhe infrastrukturës së siguruar, mundësia për ndodhjen e këtyre rasteve është shumë e ulët. Objekti është i pajisur me sipërfaqe të papërshkueshme ndaj ujit, separator vaji, sistem grumbullimi dhe impiant trajtimi të ujërave, të cilat parandalojnë përhapjen e ndotjes në rast rrjedhjesh. Në rast të derdhjeve aksidentale, personeli i trajnuar vepron menjëherë duke përdorur materiale absorbuese dhe pajisje për mbledhjen dhe asgjësimin e substancave ndotëse. Po ashtu, qendra ka të parashikuar pajisje kundër zjarrit si aparate fikëse, hidrantë dhe sinjalizim emergjent, ndërsa daljet e evakuimit janë të qarta dhe të lehta për tu përdorur. Përmes zbatimit të planit të emergjencës dhe procedurave operative standarde, ndotja e mjedisit në raste të tilla minimizohet dhe kufizohet brenda perimetrit të objektit. Prandaj, ndikimet e mundshme në raste të aksidenteve mjedisore vlerësohen si të përkohshme, të kontrollueshme dhe pa pasoja afatgjata për mjedisin përreth.

6.8 Ndikimi mjedisor nga mbeturinat

Ndikimi mjedisor nga mbeturinat është i kufizuar dhe i menaxhuar në mënyrë të kontrolluar, pasi objekti ka sistem të organizuar për ndarjen, grumbullimin dhe depozitimin e të gjitha llojeve të mbeturinave që krijohen gjatë operimit. Mbeturinat ndahen sipas kategorive përkatëse :metalike, plastike, elektrike, elektronike, vajra të përdorura, bateri dhe mbetje inerte dhe ruhen në kontejnerë të mbyllur ose në zona të mbuluara, duke parandaluar shpërndarjen në ambient. Mbetjet e rrezikshme si vajrat e përdorura, filtrat e vajit dhe mbetjet me përmbajtje kimike dorëzohen tek operatorët e licencuar për trajtim dhe asgjësim, ndërsa mbeturinat e riciklueshme dërgohen për përpunim te kompanitë partnere. Të gjitha mbeturinat komunale që

krijohen nga aktiviteti administrativ grumbullohen në kontejnerë standardë dhe largohen nga kompania kontraktuese e komunës. Përmes këtij sistemi, shmanget ndotja e ajrit, ujit dhe tokës, si dhe përhapja e aromave të pakëndshme. Për shkak të masave teknike dhe organizative të zbatuara, ndikimi mjedisor nga mbeturinat vlerësohet minimal dhe në përputhje me kërkesat ligjore për menaxhimin e mbeturinave dhe mbrojtjen e mjedisit. do paraqesim kodet e mbeturinave sipas katalogut shtetëror të mbeturinave, ku do paraqesim vetme mbeturinat e krijuara nga punëtorët dhe jo ato të cilat hyn në proces teknologjik, sepse i kemi të përmendura me lartë.

Tabela 3 Paraqitja e mbeturinave sipas katalogut shtetëror vetëm ato të krijuara nga punëtorët

Mbeturinat sipas katalogut shtetëror			
Numri sipas katalogut shtetëror të mbeturinave	Emri i Mbeturinës	Shkalla e rrezikshmërisë	Lloji i planifikuar për deponimi të mbeturinave
20 03 01	Mbeturina të përziera komunale	Jo të rrezikshme	Kontejner për mbeturina

6.9 Trashëgimia Kulturore

Si pas hulumtimit të materialeve përkatëse dhe nga informatat e siguruar ne teren dhe komunë, ne lokacionin e ngushte, ku gjendet qendra e grumbullimit të mbeturinave e kompanisë “**Rec Kos**” SH.P.K., nuk kemi monumente të trashëgimisë kulturore, historike e natyrore të cilat eventualisht do të ndikoheshin apo rrezikoheshin nga ushtrimi i veprimtarisë së kompanisë në fjalë.

7. PËRSHKRIMI I PASOJAVE TË MUNDËSHME NË MJEDIS

Pasojat e mundshme në mjedis gjatë aktivitetet që zhvillohen në kuadër të qendrës së grumbullimit, çmontimit dhe përpunimit të automjeteve mbeturinë, përpunimit të mbeturinave metalike për qëllime riciklimi, grumbullimin e vajrave të përdorura, mbeturinave nga pajisjet elektrike dhe elektronike, mbeturinave nga konstruktimi dhe demolimi, mbeturinat komunale si dhe mbeturinat e paspecifikuara ndryshëm, mund të shkaktojnë ndikime të ndryshme në komponentët e mjedisit. Megjithatë, bazuar në masat parandaluese dhe pajisjet teknike të instaluar në objekt, këto ndikime janë të kontrollueshme dhe të menaxhueshme brenda kufijve të lejuar ligjorë. Në rast të moszbatimit të standardeve teknike dhe mjedisore, pasojat mund të jenë të konsiderueshme dhe me efekte afatgjata.

Pasojat në ajër pasojat e mundshme vijnë kryesisht nga pluhuri që krijohen gjatë ngarkimit, shkarkimit dhe transportit të materialeve, si dhe nga gazrat e emetuara prej automjeteve dhe makinerive që përdoren në procesin teknologjik. Emisionet e këtyre gazrave, veçanërisht dioksidi i azotit, monoksidi i karbonit dhe grimcat PM10, mund të ndikojnë në cilësinë e ajrit brenda dhe jashtë kompleksit. Gjithashtu, gjatë përpunimit të mbeturinave vajore dhe metalike mund të lëshohen aroma të pakëndshme që ndikojnë në komoditetin e ambientit përreth, sidomos në ditët me kushte të pafavorshme atmosferike.

Pasojat në ujëra lidhen me përzierjen e ujërave atmosferike dhe teknike me substanca ndotëse si vajra, karburante, lëngje teknike dhe grimca metalike që krijohen gjatë procesit të çmontimit dhe përpunimit të mbeturinave. Gjatë reshjeve, këto ndotës mund të përhapen në rrjetin e kanalizimit apo të depërtojnë në nëntokë, duke ndikuar në cilësinë e ujërave sipërfaqësore dhe nëntokësore. Rrjedhjet aksidentale ose menaxhimi i pamjaftueshëm i ujërave të ndotura mund të shkaktojnë rritje të përqendrimit të vajrave, metaleve të rënda dhe substancave organike, duke ndikuar negativisht në ekosistemin ujqor përreth..

Pasojat në tokë pasojat e mundshme lidhen kryesisht me rrjedhjet aksidentale të vajrave, karburanteve, lëngjeve teknike dhe substancave të tjera të përdorura gjatë procesit të çmontimit të automjeteve dhe përpunimit të metaleve. Këto substanca, nëse depërtojnë në tokë, mund të shkaktojnë ndotje lokale dhe degradim të cilësisë së saj, duke ndikuar në përbërjen kimike dhe aftësinë prodhuese të shtresës sipërfaqësore. Gjithashtu, grumbullimi i përkohshëm i mbeturinave të ngurta metalike apo inertëve mund të çojë në mbetje të shpërndara dhe në përkeqësim estetik të ambientit, veçanërisht në rast të menaxhimit jo të rregullt të hapësirave të punës.

Pasojat në biodiversitet dhe peizazh janë të kufizuara, pasi objekti ndodhet në një zonë tashmë të industrializuar dhe pa habitate natyrore të rëndësishme. Megjithatë, pluhuri i krijuar gjatë ngarkim-shkarkimit dhe transportit të mbeturinave mund të ndikojë në vegjetacionin përreth, duke ulur cilësinë e ajrit dhe fotosintezën e bimëve. Zhurma dhe lëvizja e vazhdueshme e automjeteve mund të shkaktojnë largimin e faunës së vogël nga zona.

Pasojat në popullatë dhe vendbanime janë të kufizuara, pasi objekti ndodhet larg zonave të banuara dhe aktivitetet zhvillohen brenda hapësirës së mbyllur të kompleksit. Megjithatë, gjatë operimit mund të ketë ndikim të lehtë nga zhurma, pluhuri ose aroma që lëshohen gjatë

ngarkim-shkarkimit të mbeturinave, sidomos në periudha me erëra që shpërndajnë grimcat në distancë. Në rast të menaxhimit të pamjaftueshëm të mbetjeve ose ndonjë incidenti teknik, mund të ketë shqetësim të përkohshëm për komunitetin përreth. Ndikimi në shëndetin publik vlerësohet minimal dhe pa pasoja afatgjata, ndërsa ndikimi social është pozitiv për shkak të mundësive të punësimit dhe përfshirjes ekonomike lokale.

Pasojat nga zhurma dhe dridhjet janë të lidhura me punën e makinerive të rënda, presave metalike dhe automjeteve transportuese që qarkullojnë brenda kompleksit. Zhurma e vazhdueshme nga këto burime mund të shkaktojë shqetësime akustike për punëtorët dhe, në një masë shumë të kufizuar, për zonat përreth nëse pajisjet nuk mirëmbahen rregullisht.

Pasojat nga aksidentet mjedisore mund të shfaqen në rast rrjedhjesh aksidentale të vajrave, karburanteve, lëndëve kimike apo në rast zjarri në hapësirat e magazinimit. Këto ngjarje mund të shkaktojnë ndotje të menjëhershme të tokës, ujërave dhe ajrit, si dhe të rrezikojnë shëndetin e punëtorëve dhe komunitetit përreth. Në situata të tilla, ndotësit mund të përhapen shpejt në mjedis, duke dëmtuar vegjetacionin, organizmat ujorë dhe cilësinë e ajrit. Pasojat e tilla zakonisht janë të përkohshme, por mund të kenë ndikim të konsiderueshëm nëse incidentet nuk menaxhohen me masa emergjente dhe ndërhyrje të menjëhershme.

Pasojat nga mbeturinat e mbetura pas procesit lidhen me mundësinë e ndotjes së tokës, ujërave dhe ajrit nëse këto mbetje nuk menaxhohen në mënyrë të duhur. Grumbullimi i pakontrolluar i mbeturinave metalike, plastike, vajrave të përdorura apo mbetjeve elektrike dhe elektronike mund të çojë në përhapjen e pluhurit, rrjedhje të substancave vajore dhe emetim aromash të pakëndshme. Këto mbeturina mund të përmbajnë përbërës të rrezikshëm, si metale të rënda apo komponime kimike që, në kontakt me ujin ose tokën, shkaktojnë ndotje të qëndrueshme dhe dëmtojnë mikroorganizmat, florën dhe faunën përreth. Në mungesë të ndarjes dhe depozitimit të rregullt, pasojat mund të shtrihen edhe në aspektin estetik dhe higjienik të ambientit.

Pasojat në trashëgiminë kulturore janë më të rralla, por mund të shfaqen në rastet kur aktiviteti zhvillohet pranë zonave me vlera kulturore, përmes vibrimeve, ndotjes së ajrit dhe transformimit të peizazhit, të cilat ndikojnë në ruajtjen e integritetit të këtyre vlerave.

8. PËRSHKRIMI I METODAVE PËR VLERËSIMIN E PASOJAVE MJEDISORE

Metodat për vlerësimin e pasojave mjedisore janë të rëndësishme për menaxhimin dhe minimizimin e ndikimeve negative që mund të kenë projektet dhe aktivitetet në mjedis. Për të siguruar që një sistem menaxhimi mjedisor të jetë efektiv dhe të përmbushë standardet, përdoren disa metoda të caktuara që ndihmojnë në vlerësimin dhe monitorimin e ndikimeve. Ja disa nga këto metoda të përdorura për vlerësimin e pasojave mjedisore:

➤ Vlerësimi i Ndikimeve Mjedisore

Vlerësimi i Ndikimeve Mjedisore është një metodë që shqyrton ndikimet e mundshme të një projekti në mjedis para se të fillojë ai. Ky proces përfshin:

- Studimi dhe Analiza: Identifikimi i ndikimeve potenciale dhe vlerësimi i efekteve të mundshme mbi ajrin, tokën, ujin, florën dhe faunën.
- Raportimi: Krijimi i një raporti të detajuar që përmbledh gjetjet dhe rekomandimet për masat e zbutjes.
- Konsultimi: Angazhimi i palëve të interesuara dhe publikimit të raportit për të marrë komente dhe për të siguruar transparencë.

➤ Sistemi i Menaxhimit të Mjedisit

Një Sistem i Menaxhimit të Mjedisit është një metodë sistematike për të menaxhuar dhe kontrolluar ndikimet mjedisore të një organizate. Ky sistem përfshin:

- Planifikimi: Identifikimi i ndikimeve dhe krijimi i planeve për të përmbushur kërkesat mjedisore.
- Implementimi: Zbatimi i politikave dhe procedurave për të menaxhuar ndikimet mjedisore.
- Kontrolli dhe Monitorimi: Monitorimi i performancës mjedisore dhe auditimi për të siguruar përputhshmërinë me standardet dhe rregulloret.
- Përmirësimi: Rishikimi dhe përmirësimi i procedurave për të përmirësuar performancën mjedisore.

➤ Analiza e Ciklit të Jetës

Analiza e Ciklit të Jetës shqyrton ndikimet mjedisore të një produkti gjatë të gjithë ciklit të tij, nga ekstraktimi i lëndëve të para deri në përdorim. Ky proces përfshin:

- Hulumtimi i Ndikimeve: Vlerësimi i ndikimeve gjatë fazave të ndryshme të ciklit të jetës së produktit.

- Krahاسimi: Krahاسimi i ndikimeve të ndryshme për të identifikuar mundësitë për përmirësim.
- Raportimi: Krijimi i një raporti që tregon ndikimet dhe rekomandimet për përmirësim.

➤ **Studimi i Ndikimeve Ambientale dhe Shëndetësore**

Studimi i Ndikimeve Ambientale dhe Shëndetësore shqyrton ndikimet e një projekti jo vetëm në mjedis, por edhe në shëndetin e njeriut. Ky studim përfshin:

- Analiza e Rrezikut për Shëndetin: Vlerësimi i rreziqeve të mundshme për shëndetin nga ndotja dhe ekspozimi ndaj substancave të dëmshme.
- Studimi i Efekteve në Komunitet: Analiza e ndikimeve në cilësinë e jetesës dhe shëndetin e komunitetit përreth.

➤ **Analiza e Rrezikut Ambientale**

Analiza e Rrezikut Ambientale fokusohet në identifikimin dhe vlerësimin e rreziqeve që një projekt mund të sjellë për mjedisin. Ky proces përfshin:

- Identifikimi i Rreziqeve: Përcaktimi i mundësive dhe probabilitetit të ndodhisë së incidenteve ndotëse.
- Vlerësimi i Pasojave: Analiza e pasojave për ambientin në rast të ndodhisë së këtyre incidenteve.

9. PERSHKRIMI I MASAVE

Për të parandaluar dhe zvogëluar sasinë e ndikimeve negative në mjedis dhe atë në ajër, tokë, ujë si dhe në ruajtjen e shëndetit të njeriut, gjatë fazës së kryerjes së aktiviteteve për qendrën së grumbullimit, çmontimit dhe përpunimit të automjeteve mbeturinë, përpunimit të mbeturinave metalike për qëllime riciklimi, grumbullimin e vajrave të përdorura, mbeturinave nga pajisjet elektrike dhe elektronike, mbeturinave nga konstruktimi dhe demolimi, mbeturinat komunale si dhe mbeturinat e paspecifikuara ndryshëm duhet të merren masat që do të shkruhen në vijim.

9.1 Masat për zvogëlimin e ndikimeve në ajër

Për të parandaluar dhe zvogëluar sasinë e ndikimeve negative në ajër gjatë fazës të zhvillimit të aktiviteteve të qendrës së grumbullimit, çmontimit dhe përpunimit të automjeteve mbeturinë, përpunimit të mbeturinave metalike për qëllime riciklimi, grumbullimin e vajrave të përdorura, mbeturinave nga pajisjet elektrike dhe elektronike, mbeturinave nga konstruktimi dhe demolimi, mbeturinat komunale si dhe mbeturinat e paspecifikuara ndryshëm, duhet të bëhet kontrollimi i rregullt teknik i makinave ngarkuese (pirunëve) dhe transportuese që konsumojnë lëndë të lëngëta djegëse me qëllim që lirimi i gazrave nga automjetet e punës të jetë sa më kualitativ.

Në objektin, (hapësirat) e qendrës grumbulluese dhe çmontuese të automjeteve mbeturinë, komponentët e tyre dhe mbeturinave metalike me qëllim të eliminimit të erërave të ndryshme duhet bërë vendosja e ventilatorëve, me qëllim që të bëhet ventilimi i hapësirave punuese, prandaj në njërin anë të murit do të vendosen ventilatorët me biofiltër për pastrimin e ajrit, kurse në anën tjetër të murit do të vendosen hapjet për hyrjen e sasisë së ajrit të pastër që është nxjerrur me anë të ventilatorëve, gjithashtu aroma e pakëndshme do të zvogëlohet përmes ajrimit artificial përmes dritareve të vendosura në objekt. Duhet të bëhet kontrollimi i rregullt i pajisjeve për trajtimin e erërave dhe sistemit të ventilimit, pjesët e demëtuara të ndërrohen.

9.2 Masat për zvogëlimin e ndikimeve në tokë

Masat për parandalimin e ndikimeve në tokë duhet të sigurojnë që gjatë zhvillimit të aktivitetit të mos ndodhë ndotje apo degradim i saj nga rrjedhjet e vajrave, karburanteve apo substancave të tjera teknike. Të gjitha sipërfaqet operative dhe hapësirat e parkimit duhet të jenë të betonuara ose të asfaltuara, në mënyrë që të parandalohet infiltrimi i ndotësve në shtresat e tokës dhe në nëntokë. Në rastin konkret, kompania ka të gjitha sipërfaqet operative të shtruara

me asfalt, çka ul ndjeshëm rrezikun e depërtimit të ndotësve. Gjithashtu, brenda kompleksit janë ndërtuar separatorët e vajit dhe impianti për trajtimin e ujërave, të cilët mundësojnë pastrimin e ujërave teknike dhe atmosferike përpara shkarkimit të tyre në rrjetin e kanalizimit. Këto masa garantojnë mbrojtjen e tokës nga ndotja e mundshme dhe sigurojnë ruajtjen e integritetit mjedisor të zonës.

9.3 Masat për zvogëlimin e ndikimeve në ujë

Ndotja e ujit mund të vijë nga proceset teknologjike të grumbullimit të mbeturinave metalike, mbledhjes së vajrave të përdorura, si dhe nga trajtimi i mbeturinave të pajisjeve elektrike dhe elektronike, por edhe nga larja e hapësirave të brendshme dhe pajisjeve që përdoren gjatë procesit të punës. Megjithatë, impianti i kompanisë është projektuar për t'i grumbulluar dhe trajtuar këto ujëra sipas nevojës, përpara shkarkimit të tyre në rrjetin e kanalizimit. Kompania ka të ndërtuar impiantin për trajtimin e ujërave të ndotura dhe separatorët e vajit, të cilët sigurojnë pastrimin e ujërave teknologjike dhe atmosferike nga ndotësit kryesorë.

- Për minimizimin e ndikimeve në ujë do të ndërmerren masat si më poshtë: Ujërat që krijohen gjatë procesit teknologjik dhe ato atmosferike do të kalojnë fillimisht përmes separatorëve të vajit, e më pas do të dërgohen në impiantin e trajtimit për pastrim të mëtejshëm përpara shkarkimit në rrjet.
- Ujërat e krijuar nga hapësirat administrative, përpara shkarkimit në kanalizimin e fshatit, trajtohen paraprakisht në impiant për të garantuar respektimin e kufijve të lejuar të ndotjes.
- Pas trajtimit, të gjitha ujërat bashkohen dhe shkarkohen në rrjetin e kanalizimit të fshatit.
- Me qëllim të shmangies së ndikimeve të tjera të mundshme në ujërat sipërfaqësore dhe nëntokësore, investitori është i detyruar të zbatojë në mënyrë të përpiktë të gjitha ligjet dhe udhëzimet administrative në fuqi që kanë të bëjnë me mbrojtjen e ujërave dhe burimeve natyrore.

9.4 Masat për mbrojtje nga zhurma

Masat për mbrojtje nga zhurma kanë për qëllim të sigurojnë që niveli i zhurmës i krijuar gjatë procesit të punës të mos tejkalojë kufijtë e lejuar dhe të mos ndikojë në shëndetin e punëtorëve apo komunitetin përreth. Për këtë arsye, aktivitetet që krijojnë zhurmë zhvillohen vetëm gjatë orarit të rregullt të punës dhe brenda hapësirave të përcaktuara. Pajisjet dhe makineritë

teknologjike i nënshtrohen mirëmbajtjes periodike për të shmangur zhurmat e tepërta që vijnë nga konsumimi i pjesëve mekanike. Automjetet që kryejnë transportin e mbeturinave dhe materialeve punojnë me shpejtësi të kufizuar dhe me motorë të rregulluar sipas standardeve të emetimeve akustike. Këto masa sigurojnë që ndikimi i zhurmës të mbetet minimal dhe brenda standardeve të lejuara mjedisore.

9.5 Masat për zvogëlimin e ndikimeve në peizazh, florë dhe faunë

Masat për zvogëlimin e ndikimeve në peizazh, florë dhe faunë kanë për qëllim ruajtjen e ekuilibrit natyror dhe pamjes estetike të zonës përreth kompleksit. Për këtë arsye, hapësirat përreth objektit mirëmbahen rregullisht dhe mbahen të pastra nga mbeturinat, ndërsa përreth perimetrit të kompleksit është paraparë dhe do të ruhet gjelbërimi ekzistues, si dhe do të shtohen sipërfaqe me bimësi vendore për të përmirësuar cilësinë e ajrit dhe për të reduktuar përhapjen e pluhurit. Ndalohet hedhja e çdo lloj mbeturine apo materiali jashtë zonës së objektit, si dhe përdorimi i kimikateve të dëmshme për vegjetacionin. Këto masa sigurojnë që ndikimi në pamjen vizuale, florën dhe faunën të jetë minimal dhe që mjedisi përreth të ruajë stabilitetin ekologjik dhe estetik.

9.6 Masat për zvogëlimin e ndikimeve në vendbanime dhe popullatë

Masat të cilat duhet të merr kompania “Rec Kos” SH.P.K., për qëllim mbrojtjen e shëndetit dhe mirëqenies së komunitetit përreth nga efektet e mundshme të aktivitetit të kompanisë. Duke qenë se objekti ndodhet në zonë industriale dhe në distancë të sigurt nga vendbanimet, ndikimi është minimal, megjithatë ndërmerren masa parandaluese për të shmangur çdo shqetësim të mundshëm. Kryhet pastrim i rregullt i sipërfaqeve për të parandaluar përhapjen e pluhurit dhe mbeturinave në ajër, ndërsa automjetet që hyjnë dhe dalin nga objekti pastrojnë rrotat për të mos ndotur rrugët publike. Gjithashtu, kompania siguron që emetimet nga proceset e punës të jenë nën kufijtë e lejuar ligjorë dhe zbaton standardet e sigurisë në punë për mbrojtjen e punëtorëve. Këto masa garantojnë që ndikimi në popullatë dhe në zonat e banuara të mbetet i papërfillshëm dhe i kontrolluar plotësisht.

9.7 Masat për menaxhimin e mbeturinave

Masat për menaxhimin e mbeturinave kanë për qëllim sigurimin e trajtimit të duhur të mbetjeve të krijuara gjatë procesit të punës, në mënyrë që të parandalohet ndotja e tokës, ujit dhe ajrit. Brenda kompleksit të kompanisë “**Rec Kos**” Sh.p.k., të gjitha mbeturinat ndahen në mënyrë të rregullt sipas llojit të tyre dhe ruhen në vende të përcaktuara e të mbrojtura nga reshjet.

Gjatë procesit të grumbullimit dhe çmontimit të automjeteve, si dhe përpunimit të metaleve dhe mbeturinave të tjera, bëhet ndarja e qartë e mbeturinave metalike, plastike, vajrave të përdorura, mbeturinave elektrike e elektronike, mbetjeve inerte dhe atyre komunale. Mbetjet metalike, plastike dhe ato të riciklueshme dërgohen për përpunim në linjat përkatëse të kompanisë, ndërsa mbetjet jo të riciklueshme dorëzohen tek operatorë të licencuar për trajtim.

Vajrat e përdorura dhe mbeturinat e rrezikshme ruhen në enë hermetike dhe në paleta mbrojtëse për të parandaluar rrjedhjet. Mbetjet e ngurta depozitohen përkohësisht në hapësira të veçanta, me dysheme të papërshkueshme, dhe më pas transportohen për trajtim sipas legjislacionit në fuqi. Zona e punës pastrohet rregullisht për të shmangur grumbullimin e mbetjeve dhe ndotjen e mjedisit përreth. Ujërat që rrjedhin nga sipërfaqet operative kalojnë përmes separatorëve të vajit dhe më pas në impiantin e trajtimit, përpara shkarkimit në rrjetin e kanalizimit.

Gjithashtu, kompania mban evidencë të sasisë, llojit dhe mënyrës së trajtimit të çdo kategorie mbetjesh, duke siguruar transparencë në menaxhimin e tyre. Këto masa garantojnë menaxhim të sigurt, të kontrolluar dhe në përputhje me standardet ligjore për mbrojtjen e mjedisit.

Menaxhimin e mbeturina të ngurta komunale klasifikohen dhe të vendosen në kontejnerë të posaçëm të pajisur me kapak për mbulim me qëllim të mbrojtjes së tokës dhe ujërave nëntokësor, dhe pastaj mirën nga kompani komunale për menaxhimin e mbeturinave.

Plani i menaxhimit me mbeturina përfshinë aktivitetet për evitimin dhe reduktimin e prodhimit të mbeturinave dhe ndikimit të tyre në mjedis dhe shëndetin e njeriut, Plani për menaxhimin e mbeturinave përmban, masat e zbatuara me qëllim të parandalimit të krijimit të mbeturinave, zvogëlimit të sasisë së tyre zbatimin e masave dhe teknikave për mbrojtjen e mjedisit dhe shëndetin e njeriut, përcaktimin e mënyrës për magazinimin, trajtimin, riciklimin dhe deponimin e mbeturinave.

9.8 Masat rehabilituese

Për të zvogëluar ndikimet negative dhe për të rehabilituar mjedisin pas aktiviteteve industriale, “Rec Kos” SH.P.K. mund të ndërmarrë masat e mëposhtme:

- **Rikuperimi i Habitatit** - Mbjellja e bimëve vendase për të rikuperuar ekosistemet natyrore dhe për të rivendosur biodiversitetin. Formimi i hapësirave të gjelbra që ofrojnë strehim për faunën dhe përmirësojnë cilësinë e ajrit.
- **Trajtimi i Tokës** - Përdorimi i teknologjive për të pastruar tokën nga ndotësit, përfshirë teknikat e bioremedimi dhe fitoremedimi. Implementimi i masave për të parandaluar

erozionin, si ndërtimi i barrierave dhe mbjellja e bimëve për stabilizim.

- **Menaxhimi i Ujërave** - Zhvillimi i sistemeve për trajtimin e ujërave të ndotura dhe riciklimin e ujit për përdorim të sigurt.
- **Monitorimi dhe Vlerësimi** - Krijimi i një programi të vazhdueshëm për të monitoruar cilësinë e ajrit, ujit dhe tokës pas rehabilitimit. Publikimi i të dhënave për të informuar publikun dhe për të siguruar transparencë në proceset e rehabilitimit.
- **Edukimi dhe Ndërgjegjësimi** - Ofrimi i trajnimeve për punonjësit mbi metodat e rehabilitimit dhe ruajtjes së mjedisit. Organizimi i aktiviteteve për të edukuar komunitetin mbi rëndësinë e rehabilitimit të mjedisit dhe mënyrat për të kontribuar.

9.9 Komponentë mjedisore, potenciali për ndikim, veprimet që shkaktojnë ndikimet dhe masat për parandalimin e këtyre ndikimeve

Komponenti mjedisore	Potenciali për ndikim negativ	Veprimi që shkakton ndikimin	Masat që duhet të ndërmerren
Ajri	Ndotje nga pluhuri dhe gazrat e automjeteve dhe makinerive.	Ngarkim-shkarkim materialesh; transport; prerje e metaleve; proces mekanik.	Spërkatje periodike e sipërfaqeve; pastrim i vazhdueshëm i zonës; mirëmbajtje e automjeteve; ndalimi i djegieve të mbeturinave.
Uji dhe toka	Rrezik ndotjeje nga rrjedhjet e vajrave, karburanteve dhe substancave teknike. Derdhja e ujërave direkt në kanalizimin e fshatit.	Infiltrimi të substancave ndotëse përmes sipërfaqeve të dëmtuara si ujërave të dëmtuar apo vajrave.	Sipërfaqet operative janë të asfaltuara; materialet ruhen në enë hermetike me paleta mbrojtëse; përdorim materialesh absorbuese në rast rrjedhjeje; pastrim periodik i zonës. Trajtim i ujërave përmes separatorëve të vajit dhe impiantit për pastrim; kontroll periodik i cilësisë së ujit; mirëmbajtje

			e rregullt e kanalizimit teknik.
Natyra dhe biodiversiteti (flora dhe vegjetacioni, fauna, Zonat e mbrojtura të natyrës)	Humbje ose dëmtim i habitatit, stres nga ndotja, zhurma dhe drita artificiale.	Ndotja e ajrit, tokës dhe ujërave, gjate proceseve teknologjike, drita dhe lëvizjet e mjeteve.	Ruajtja dhe mirëmbajtja e gjelbërimit përreth kompleksit; ndalimi i hedhjes së mbeturinave; pastrim i rregullt i zonës; ndalimi i kimikateve të dëmshme.
Zhurma	Rritje e nivelit të zhurmës gjatë operimeve mekanike.	Funksionimi i makinerive presa, qarkullimi i mjeteve transportuese.	Përdorim pajisjesh me efikasitet akustik; mirëmbajtje periodike; kufizim i orarit të punës; përdorim i mbrojtëseve për dëgjim nga punëtorët.
Shëndeti i qytetareve dhe konsumatorëve	Ndikim i kufizuar nga pluhuri, zhurma dhe aromat e procesit të punës.	Emisionet nga proceset, transporti, veprimet e proceseve teknologjike dhe mekanike ruajtja e mbetjeve të rrezikshme, si vajrave.	Kufizim i orarit të punës; pastrim i rrugëve hyrëse; kontroll i emetimeve; respektim i distancës mbrojtëse nga vendbanimet.

10. PËRSHKRIMI I PASOJAVE NEGATIVE MJEDISORE

Aktiviteti i kompanisë “**Rec Kos**” Sh.p.k. mund të shkaktojë disa ndikime negative në mjedis, kryesisht nëse masat teknike nuk zbatohen si duhet.

Në tokë, pasojat lidhen me rrjedhjet e vajrave, karburanteve dhe lëngjeve teknike që mund të ndotin shtresat e tokës dhe të dëmtojnë strukturën e saj.

Në ujë, ndotja mund të vijë nga përzierja e ujërave teknike dhe atmosferike me substanca ndotëse si vajra, metale dhe mbetje kimike, sidomos gjatë reshjeve ose pastrimit të pajisjeve.

Në ajër, ndikimi negativ vjen nga pluhuri i krijuar gjatë ngarkim-shkarkimit të mbeturinave dhe nga gazrat e automjeteve.

Në aspektin e zhurmës, pajisjet mekanike dhe mjetet transportuese mund të shkaktojnë shqetësime për punëtorët dhe zonën përreth.

Në florë, faunë dhe peizazh, ndikimi është i kufizuar, por përfshin shpërndarjen e pluhurit, zhurmën dhe ndryshimin e pamjes estetike të zonës.

Në popullatë, ndikimet janë të vogla, por mund të ndjehen përkohësisht si aromë apo pluhur gjatë periudhave me ngarkesë pune.

Në raste aksidentale, si rrjedhje ose zjarr, mund të ndodhë ndotje e menjëhershme e tokës, ujit dhe ajrit.

Në tërësi, këto ndikime janë të përkohshme dhe të menaxhueshme me zbatimin e masave parandaluese dhe mirëmbajtjen e rregullt të sistemit teknik.

11. MONITORIMI DHE RAPORTIMI

Monitorimi dhe raportimi përbëjnë një komponent thelbësor të menaxhimit mjedisor gjatë procesit të grumbullimit, çmontimit dhe përpunimit të automjeteve mbeturinë, përpunimit të mbeturinave metalike për qëllime riciklimi, grumbullimin e vajrave të përdorura, mbeturinave nga pajisjet elektrike dhe elektronike, mbeturinave nga konstruktimi dhe demolimi, mbeturinat komunale si dhe mbeturinat e paspecifikuara ndryshëm. Monitorimi kryhet në mënyrë të rregullt mbi cilësinë e ajrit, ujërave, tokës, zhurmës dhe mbetjeve të mbetura nga proceset teknologjike. Në ajër, vëzhgohen emisionet e gazrave dhe pluhurit përmes sistemeve të matjes së vazhdueshme (CEMS), duke kontrolluar parametrat si CO₂, CO, NO_x, SO₂, pluhur të imët dhe komponime organike të paqëndrueshme. Ujërat monitorohen për pH, BOD₅, COD, metale të rënda dhe parametra të tjerë sipas Udhëzimit Administrativ Nr. 02/2022 për shkarkimin e ujërave të ndotura. Tokat dhe ujërat nëntokësore testohen periodikisht për të identifikuar ndonjë kontaminim nga derdhjet apo infiltrimet, ndërsa për zhurmën kryhen matje akustike në kufi të objektit për të siguruar që niveli i saj mbetet nën kufijtë e lejuar.

Monitorimi përfshin gjithashtu edhe mbetjet e ngurta dytësore (hi, llumra, precipitate), të cilat analizohen për përmbajtjen e substancave të rrezikshme përpara deponimit final. Procesi shoqërohet me mbajtjen e regjistrave të detajuar për sasinë, llojin dhe trajtimin e çdo mbetjeje, të cilat shërbejnë për raportim zyrtar.

Raportet mjedisore përgatiten sipas kërkesave të Ministrisë së Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës dhe organeve inspektuese, zakonisht në baza tremujore ose vjetore, dhe përmbajnë të dhëna mbi rezultatet e monitorimit, krahasimin me standardet ligjore, masat e zbatuara dhe rekomandimet për përmirësim.

Ky sistem siguron evidence dhe transparencë, duke i mundësuar autoriteteve dhe komunitetit të kenë informacion të qartë mbi ndikimet reale në mjedis, si dhe garanton që operatori të ndërmarë masa korrigjuese në rast të tejkalimit të kufijve të lejuar.

12. PËRFUNDIM

Duke i analizuar të gjitha parametrat e procesit të punës në objektet qendres për grumbullimin, çmontimin dhe përpunimit të automjeteve mbeturinë, përpunimit të mbeturinave metalike për qëllime riciklimi, grumbullimin e vajrave të përdorura, mbeturinave nga pajisjet elektrike dhe elektronike, mbeturinave nga konstruktimi dhe demolimi, mbeturinat komunale si dhe mbeturinat e paspecifikuara ndryshe (Rritja e Kodeve shtese) që ndodhet në Sankoc komuna e Glllogocit, zhvillohet në kushte të kontrolluara dhe me infrastrukturë të përshtatshme për mbrojtjen e mjedisit. Nga analiza e bërë rezulton se ndikimet kryesore lidhen me ndotjen e ajrit, ujit, tokës, ndikimin në biodiversitet dhe shëndetin e popullatës, dhe janë të kufizuara, të përkohshme dhe të kthyeshme, ndërsa masat parandaluese të parashikuara – si funksionimi i impiantit të trajtimit të ujërave, përdorimi i separatorëve të vajit, mirëmbajtja e rregullt e makinerive, ndarja e mbeturinave sipas kodit të tyre, kontrolli periodik i parametrave mjedisorë dhe mbajtja e pastërtisë në kompleks – garantojnë mbrojtjen e plotë të komponentëve mjedisorë. Po ashtu, gjatë procesit teknologjik krijohen mbetje dytësore, si mbetje metalike , plastike, eklektikë, vakra dhe ujëra te ndotura, ku të gjitha këto mbetje identifikohen, ndahen sipas llojit dhe kodit të tyre në përputhje me Katalogun Shtetëror të Mbeturinave, ruhen në hapësira të përcaktuara dhe trajtohen në përputhje me legjislacionin për menaxhimin e mbeturinave, duke u dërguar për riciklim ose për trajtim tek operatorë të licencuar.

Megjithatë, me zbatimin e teknologjive bashkëkohore, aplikimin e masave parandaluese e zvogëluese, si dhe me një sistem të rregullt të monitorimit dhe raportimit, këto ndikime mund të reduktohen në nivele të pranueshme dhe të menaxhueshme. Zbatimi i standardeve ligjore dhe mjedisore, menaxhimi i kujdesshëm i magazinimit, transportit dhe përpunimit, si dhe përfshirja e planeve emergjente për raste aksidentesh sigurojnë jo vetëm mbrojtjen e mjedisit dhe shëndetit publik, por edhe përfitime ekonomike e sociale nëpërmjet riciklimit dhe rigjenerimit të materialeve të vlefshme.

Tabela 4 Tabela e kodeve ekzistuese te mbeturinave dhe atyre shtese te kërkuara nga Kompania.

Tabelave e kodeve me Leje dhe Atyre shtesë të kërkuara					
02 01 10	10 12 06	13 02 08*	16 01 09*	17 02 03	19 12 04
04 01 09	10 12 08	13 05 06*	16 01 13*	17 04 01	19 12 05
04 02 09	10 13 01	13 05 07*	16 01 17	17 04 02	20 01 01
07 02 13	10 13 04	15 01 01	16 01 18	17 04 03	20 01 02
08 01 11*	11 05 01	15 01 02	16 01 19	17 04 04	20 01 11
08 01 12	11 05 02	15 01 03	16 01 20	17 04 05	20 01 23*
10 01 01	12 01 13	15 01 04	16 02 09*	17 06 01*	20 01 34
10 01 02	13 01 09*	15 01 05	16 02 12*	17 06 03*	20 01 36
10 03 02	13 01 10*	15 01 07	16 06 01*	17 06 04	20 01 39
10 03 05	13 01 11*	15 01 09	16 06 05	17 06 05*	20 01 40
10 03 20	13 01 12*	15 01 11*	16 08 01	17 08 02	20 01 41
10 04 01*	13 01 13*	15 02 02*	17 01 01	17 09 04	20 03 01
10 06 01	13 02 04*	16 01 03	17 01 02	19 10 01	20 03 02
10 09 03	13 02 05*	16 01 04*	17 01 03	19 12 01	20 03 04
10 10 03	13 02 06*	16 01 06	17 01 07	19 12 02	20 03 99
10 12 01	13 02 07*	16 01 07*	17 02 02	19 12 03	

Duke u bazuar në natyrën e punës së qendrës dhe aktivitetit të sajë, vendndodhjen, kapacitetin dhe intensitetin e veprimeve, mund të konstatohet se ndikimet në mjedisin lokal janë të kontrollueshme. Mendojmë se këto të dhëna janë të mjaftueshme për raport të VNM-së dhe i propozojmë institucionit kompetent përkatësisht Ministrisë së Mjedisit, Planifikimit Hapësinorë dhe Infrastrukturë (MMPHI), për dhënien e mendimit pozitiv për Pëlqim Mjedisor për rritjen e numrit të kodeve sipas kërkesës së investitorit – qendrës për grumbullimin, çmontimin dhe përpunimit të automjeteve mbeturinë, përpunimit të mbeturinave metalike për qëllime riciklimi, grumbullimin e vajrave të përdorura, mbeturinave nga pajisjet elektrike dhe elektronike, mbeturinave nga konstruktimi dhe demolimi, mbeturinat komunale si dhe mbeturinat e paspecifikuara ndryshe që ndodhet në Sankoc, Komuna e Gllgocit.

13. LITERATURA E PERDORUR

Lista e bibliografisë (referencave) së burimeve të përdorura për përshkrimet dhe vlerësimet e përfshira në raport.

- *Te dhënat nga Investitori,*
- *PZHK-Drenas-16.06.20-min.size .pdf*
- *Kërko dhe paraqit - KGP*
- *Hartë*
- *Google Maps*
- *LIGJI NR. 08/L-181 PËR VLERËSIMIN E NDIKIMIT NË MJEDIS (rks-gov.net)*
- *UDHËZIM ADMINISTRATIV Nr. 13/2013 PËR KATALOGUN SHETËROR TË MBETURINAVE*